



Krifca, takim me përfaqësues të KASH: Do intensifikojmë partneritetin

Faqe 2



Shqipëria dhe Izraeli heqin taksimin e dyfishtë, nxitje investimeve

Faqe 5



Mekanizmat, reformat dhe mikroreformat, të cilat çojnë drejt "Bujqësisë së Gjelbër"

Faqe 6



# AGROBIZNESI

**FED invest**

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,  
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.  
Tel: +355 4 2 251 910 /911  
Email: info@fedinvest.al  
kontakt@fedinvest.al  
www.fedinvest.al

## BOTIM I KESHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445  
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

E Diel, 10 Tetor 2021

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 424  
Çmimi 125 lekë

E përdryjavshme e pavarur

# NDRYSHIMET KLIMATIKE, PASOJAT TEK TOKA DHE UJ "BUJQËSIA, TOKA PO UL RENDIMENTIN, PO RRITEN KOSTOT DHE REDUKTOHEN KULTIVARËT"

Agim Rrapaj, kreu i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, në një intervistë për prestigjozen ekonomike revistën "Monitor", shprehet se pasojat e ndryshimeve klimatike dhe dëmit njerëzor, duke mos reaguuar, shfaqen qartësisht në bujqësi përmes uljes së rendimentit në prodhim, rritjes së kostove apo edhe uljes së numrit të kulturave që kultivohen. "Në këtë kontekst, duhet të merren masa," thekson Rrapaj

## RISI ALBANIA

Bashkëpunim 8-vjeçar KASH dhe RisiAlbania mjaft dobiprurës në funksion të rritjes së punësimit për të rinjtë, inovacionit dhe informimit të fermerëve në të gjithë vendin



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Faqe 2



## GLOBALG.A.P.

Standardi GlobalG.A.P. në fruta-perimet  
"Made in Albania", krijohet grupi teknik

Faqe 5

## KËNDI I EKSPERTIT

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË,  
SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

Faqe 11, 12

Krifca pret Salinas:  
Forcim dhe zgjerim të marrëdhënieve me BB



Faqe 4

## AGROTURIZËM

Do të ngresh një bujtinë,  
fermë apo biznes në fshat?  
Veliaj prezanton nismën  
për gratë dhe vajzat e Tiranës



Faqe 4

**TASE GROUP**

Adresa: Rruga e Kavajës, Qendra "Kondor", Tiranë;  
Cel.: 0672035581; 0684855580

PIESE MOTORIKE  
FREKSIONE  
PERMISTOPA  
KUSHINETA  
BRIPI  
AKSE  
PIESE ELEKTRIKE  
PIESE HIDRAULIKE  
VAJRA DHE FILTRA

**Koyo** **bepco** **FAG**



## RISI ALBANIA

*Bashkëpunimi KASH me RisiAlbania nisi 8 vite më parë, me procesin e informimit të fermerëve, përmes Gazetës "Agrobiznesi", në të cilën janë botuar mbi 200 artikuj, u mundësua rritja e tirazhit të gazetës nga 400 kopje në rreth 3000 kopje mesatarisht në muaj. Lexuesit dhe abonimet u rritën ndjeshëm, duke e çuar gazetën përmes Postës Shqiptare në institucionet publike, ministritë, përfaqësitë diplomatike, projektet e donatorëve, qarqet, prefekturat, bashkitë, njësitë vendore, tek fermerët dhe subjektet e agrobiznesit deri në zonat e thella rurale, me potenciale të spikatura për prodhimin bujqësor, bimët medicinale dhe aromatike, agroturizmin etj. Informimi, mbrojtja e interesave, mbështetja për botimin e gazetës është vlerësuar si shumë dobiprurëse prej lexuesve. Gjithashtu RisiAlbania ka mbështetur disa kërkesa dhe iniciativa tepër të nevojshme dhe shumë dobiprurëse për fermerët dhe subjektet e agrobiznesit si:*

### I. Reduktimin e çmimit të karburantit:

Ka qenë kërkesë e vazhdueshme e fermerëve dhe të gjitha subjekteve që operojnë në hallkat e zinxhirit të prodhimit dhe furnizimit me ushqime. Gjithashtu ka qenë dhe një ndër objektivat madhorë të KASH, e mbështetur edhe nga shoqatat simotra Biznes Albania, Enti Kombëtar Rural, Albania Food Industri, Bashkimi Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, Uni-



versitetit Bujqësor i Tiranës, Fakulteti Ekonomisë i Universitetit të Tiranës.

Një ndër aktivitetet më të rëndësishme të organizuara në mbështetje të realizimit të këtij objekti madhor të KASH ka qenë përgatitja e fushatës së advokimit dhe konceptit bazë për advokim ndaj qeverisë.

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, përmes Projektit RisiAlbania ka dhënë një ndihmesë të madhe në këtë proces. Kjo mbështetje u finalizua me përgatitjen e konferencës kombëtare: "Drejt formalizimit të Sektorit të Agrobiznesit, për më shumë rritje ekonomike, investime dhe punësim", e

## Bashkëpunim 8-vjeçar KASH dhe RisiAlbania mjaft dobiprurës në funksion të rritjes së punësimit për të rinjtë, inovacionit dhe informimit të fermerëve në të gjithë vendin

mbajtur në datën 2 dhjetor 2015 dhe me pjesëmarrjen e shumë aktorëve të rëndësishëm të sektorit si edhe Ministrit të Bujqësisë së asaj kohe z. Edmond Panariti.

Mbështetja nga Qeveria Zvicerane përmes projektit RisiAlbania pati një rol të veçantë dhe me rëndësi për arsye se:

(i) Kontribuoi në përmirësimin e konceptit të advokimit dhe për të prezantuar më së miri çështjen duke shtuar vlerë në rritjen e kapacitetit të shoqatave në këtë drejtim;

(ii) Bëri të mundur bashkëpunimin e KASH, shoqatave si motra, ekspertëve të pavarur midis tyre si dhe me ato të institucioneve të arsimit të lartë;

(iii) Lehtësoi pjesëmarrjen në konferencë të përfaqësuesve të disa institucioneve publike si ato të Kuvendit të Shqipërisë, Qeverisë, Ministrive të linjës dhe donatorëve të tjerë, duke u mundësuar të njihen me propozimet e sektorit privat për realizimin e kërkesës për reduktimin e çmimit të karburantit.

(iv) Prezantimet dhe diskutimet në konferencë qartësuan shumë nga çështjet dhe problemet që pengonin realizimin e procesit të reduktimit të çmimit të karburantit, siç janë ato të: Skemës së shpërndarjes

ve përmes përgatitjes së rubrikave të reja, cilësore, promovimit të potencialeve dhe shembujve pozitivë të të rinjve, për informimin dhe nxitjen e të rinjve, për të punuar në sektorin e Fruta Perimeve, Bimëve Mjekësore dhe Aromatike, IT, si dhe mbështetjen për kualifikimin e një grupi të rinjsh,



për menaxhërit të eksportit të fruta perimeve duke kontribuar në rezultatet pozitive të arritura në mënyrë të qëndrueshme nga ky sektor.

(ii) Rritjen e tirazhit dhe dërgimin e gazetës "Agrobiznesi" edhe tek fermerë e subjekte që operojnë në zonat e thella rurale, me akses e mundësi të kufizuara të mjeteve të tjera të informimit.

### III. Kryerjen e studimit: "Mbi zinxhirin e vlerës në tregun vendas të fruta perimeve",

i cili ndihmoi shoqatat anëtare të KASH, për vlerësimin e situatës së krijuar mbas tërmetit dhe pandemisë Covid -19, duke ua lehtësuar punën për marrjen e masave efikente në vijimësi për:

(i) Rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës në sektorin privat, konkretisht në tre nënsektorët e përzgjedhur: Agrobiznesi, Turizmi dhe (TIK-u) Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (kërkesa e tregut të punës);

(ii) Rritjen e aksesit në informacion, në lidhje me mundësitë e punësimit dhe tregun e punës dhe shërbimet (ndërmjetësimi); Si dhe të aftësojë veçanërisht të rinjtë, për të përmirësuar ofertën e ofruesve privatë të trajnimeve në tre sektorë të përzgjedhur (oferta e tregut të punës).

(iii) Gjithashtu në sektorin e agrobiznesit mbështetja e RisiAlbania dhe ky studim

kontribuan në rritjen e investimeve dhe eksportit, veçanërisht në sektorin e frutave dhe perimeve, dhe nënsektorin e Bimëve Medicinale dhe Aromatike.

### IV. Mbështetjen dhe përfundimin me sukses, për herë të parë i procesit të certifikimit në grup të Shoqërive të Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB) për pajisjen e tyre me certifikatën e cilësisë GlobalG.A.P.

(i) SHBB "Agro ISAK" është subjekti i parë si SHBB, që është pajisur me certifikatën GlobalGAP, falë mbështetjes së Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, përmes Projektit RisiAlbania. Certifikimi i kësaj SHBB do të na ndihmojë shumë në procesin e certifikimit në grup, mbasi shërben si një model pozitiv, për zbatimin e procesit të certifikimit në grup edhe për SHBB në të gjithë vendin. Sipas të dhënave të GlobalG.A.P.

dim janë mbështetur disa subjekte si Doni Fruit, i cili arriti të dyfishojë sipërfaqen e certifikuar me GlobalG.A.P. nga 63 ha në 130 ha. Gjithashtu në këtë proces mbështetje u është dhënë edhe subjekteve

në shkallë botërore 73% e fermave të certikuara me certifikatën GlobalG.A.P. janë grupime dhe vetëm 27% subjekte individuale.

(ii) Me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, përmes Projektit RisiAlbania në periudhën 2019 e në vazh-



dim janë mbështetur disa subjekte si Doni Fruit, i cili arriti të dyfishojë sipërfaqen e certifikuar me GlobalG.A.P. nga 63 ha në 130 ha. Gjithashtu në këtë proces mbështetje u është dhënë edhe subjekteve

Tomato Al, LEA 2011, etj., të cilët kanë mundësuar gjetjen e tregjeve të reja për eksport me çmime deri 30% më të larta se sa shitej i njëjti produkt më parë pa u certifikuar.

(iii) Konstituimi i Grupit Kombëtar Teknik të Punës për Standardin GlobalG.A.P. në Shqipëri është një tjetër arritje e realizuar me mbështetjen e RisiAlbania. Gjithashtu u përgatit nga ky grup propozimi për MBZHR, për rritjen e mbështetjes dhe masës së financimit të procesit të certifikimit në grup, përmes amendim/shtesë në VKM nr.

### KASH - MBZHR

## Krifca, takim me përfaqësues të KASH: Do intensifikojmë partneritetin

"Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) është një partner i rëndësishëm i

përbërë nga fermerë, prodhues e agropërpunues për të rrahur mendim, dëgjuar e nënvizuar

sfidat që kemi përpara me programin e bujqësisë për çdo sektor dhe për të vetëdijësuar për rëndësinë e veçantë, që kanë të gjithë aktorët në organizimin e punëve në bujqësi si një trupë".

KASH përfshin në vetvete 25 shoqata kombëtare dhe 12 këshilla rajonale të agrobiznesit që operojnë në sektorët e Bujqësisë, Blegtorisë, Peshkimit dhe Akuakulturës, Agrobiznesit, Agropërpunimit, Bimëve të Mjekësisë Aromatike dhe Bletarisë, Agroturizmit, Agropylltarisë dhe Mjedisit në zonat rurale, Tregjeve agrolektorale, Financës dhe Mikrofinancës.



Ministritë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) në shumë procese konstruktive në detyrat e bujqësisë".

Kështu u shpreh ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, gjatë një takimi që zhvilloi në ambientet e MBZHR-së, me përfaqësues të KASH-it, ku ndër tjera theksoi, që dëshiron veçse ta intensifikojë këtë partneritet.

"Në kuadër të këtij bashkëpunimi, vijoi ajo, mirëpritja në një dialog anëtarët dhe drejtuesit e qarqeve të Këshillit të





## INTERVISTA

## NDRYSHIMET KLIMATIKE, PASOJAT TEK TOKA DHE UJI

# “BUJQËSIA, TOKA PO UL RENDIMENTIN, POR RRITEN KOSTOT DHE REDUKTOHEN KULTIVARËT”

*Agim Rrapaj, kreu i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, në një intervistë për prestigjiozen ekonomike revistën “Monitor”, shprehet se pasojat e ndryshimeve klimatike dhe dëmit njerëzor, duke mos reaguuar, shfaqen qartësisht në bujqësi përmes uljes së rendimentit në prodhim, rritjes së kostove apo edhe uljes së numrit të kulturave që kultivohen. “Në këtë kontekst, duhet të merren masa,” thekson Rrapaj*

Flet Agim Rrapaj, Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

*Ndryshimet klimatike, kombinuar me indiferencën njerëzore mund të shkaktojnë pasojat e jashtëzakonshme në dy nga elementet bazë të jetës, toka dhe uji. Në këtë kontekst ka nevojë për më shumë vëmendje, sepse ai që kërcënohet është zinxhiri ushqimor.*

*Agim Rrapaj, kreu i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar shprehet se pasojat e ndryshimeve klimatike dhe dëmit njerëzor, duke mos reaguuar, shfaqen qartësisht në bujqësi përmes uljes së rendimentit në prodhim, rritjes së kostove apo edhe uljes së numrit të kulturave që kultivohen.*

*Në këtë kontekst, nëse nuk merren masa, Shqipëria rrezikon të kthehet në një vend që importon shumë prej produkteve që dikur dhe sot i prodhon vetë.*

*Ndryshimet klimatike janë dukur si një nocion abstrakt për shumicën e njerëzve, por efektet e tyre kanë filluar të ndihen çdo vit e më shumë. Sa e kërcënuar është Shqipëria nga këto ndryshime në këndvështrimin tuaj?*

Është e kërcënuar seriozisht. Ndryshimet klimatike, në radhë të parë, ndikojnë në tokë dhe ujë, që janë baza ku zhvillohen hallkat e zinxhirit ushqimor. Zhvillohet bujqësia, blegtoia, peshkimi, akuakultura, agrobiznesi, agropërpunimi, bletaria, bimët mjekësore, tregjet agroblegtoiale, agroturizmi. Duhet të kemi parasysh të gjitha këto hallka të zinxhirit për të kuptuar se sa ndikim kanë tek njëra-tjetra. Ndryshimet klimatike, nëse i shohim me kujdes, kanë ndikuar tek toka, sidomos në lidhje me erozionin.

Mungesa e masave për parandalimin e këtij fenomeni ka bërë që shpesh të hiqet dorë nga investime të caktuara. Erozioni heq pjesën më produktive të tokës dhe e çon atë në det. Ky është ndikimi i parë i rëndësishëm i kushteve klimatike. E dyta ka të bëjë me braktisjen e tokës. Shqipëria është vendi me më pak tokë bujqësore për frymë në rajon. Për fat të mirë, ne kemi pasur tokë, por me ndryshimet në vitet '90 kemi zbritur në 410 mijë hektarë. Janë rreth 110 mijë hektarë tokë pa zot, sepse nuk u pranuan nga fermerët të cilëve iu dha me Ligjin 7501. Këto janë në mëshirën e fatit dhe ndikimin e kushteve, për të mos thënë që janë të degraduara dhe pa produktivitet. Kemi 100 mijë hektarë që janë produktivë, por nuk punohen për shkak të braktisjes që iu është bërë nga poseduesit. Në këtë aspekt besoj se ka ndikuar fakti që nuk kemi dhënë certifikatat e pronësisë për shumicën e tokës bujqësore. Për këtë arsye kemi arritur në atë fazë ku investimet për këtë sipërfaqe toke janë pezulluar.

Duhet të jemi të bindur që askush nuk investon në tokë kur nuk ka certifikatë. Element tjetër i rëndësishëm ka të bëjë me çështjen e blegtorisë. Ne

ndër vite kjo tokë.

Nuk duhet të harrojmë se kemi 647 rezervuarë për ujtitje, por realisht pjesa më e madhe e tyre nuk kryen funksionin për të cilin janë krijuar për arsye nga më të ndryshmet, por më e rëndësishmja, mungesa e investimeve. Ne sot për gjithë zinxhirin bujqësor që jep 20-21% të PBB, marrim nga buxheti i shtetit vetëm 2.2%. Kjo është e pamjaftueshme për të mirëmbajtur njësinë bazë që është toka dhe uji.

**Si e ndikojnë bujqësinë ndryshimet klimatike që sjellin temperaturat më ekstreme, thatësitrat, përmbytjet? A i ndien bujqësia shqiptare këto ndryshime?**



kemi mbajtur 50% të tokës për kulturat foragjere që të ruajnë strukturën e saj, por edhe blegtoia po vjen duke u reduktuar dhe sipërfaqja e tokës që i kushtohet po ulët.

Lidhur me ujin, ai është pasuria më e madhe që kemi, gjithëvjetor dhe i pastër. Por kemi zbritur nga 400 mijë hektarë tokë të ujitura në 235 mijë hektarë. Një tokë që nuk ujitet, nën ndikimin e kushteve atmosferike, zjarreve, përmbytjeve, rrebesheve dhe thatësirës e redukton ndjeshëm prodhimin e saj. Natyrisht që kanë ndikuar dhe faktorë të tjerë, por vitet e fundit veçanërisht breshëri, përmbytjet dhe zjarri kanë ndikuar negativisht në sipërfaqe të konsiderueshme, duke bërë që të mos marrim prej saj atë që presim ose atë çfarë ka dhënë

Ndikojnë tek ulja e prodhimit për njësi të sipërfaqes. Është ulur rendimenti, janë rritur kostot dhe janë reduktuar kultivarët që ndikojnë ndjeshëm tek mekanizimi. Të gjitha këto së bashku ulin nivelin e prodhimit në njësi për sipërfaqe dhe rrisim, nga ana tjetër, importet.

Ne kemi kapacitete në blegtori të furnizojmë me të gjithë asortimentet jo vetëm tregun vendas, por edhe më gjerë. Fakti është që sot importojmë 200 milionë euro në vit produkte ushqimore të këtij grupi dhe kjo shifër kaq e lartë vjen si rezultat i uljes së prodhimit dhe mbjelljes së kultivarëve në tokat tona që nuk janë më ato që kanë qenë nga pikëpamja e prodhueshmërisë.

Po të shohësh në zonën e Korçës ka nisur një përmbytje

në zonën e Maliqit dhe kthimi në kënetë i shumë sipërfaqeve që për mangësi të hidrovorëve nuk bëjnë më tërheqje të ujit siç bëhej më parë. Ky fenomen quhet “moçalizim”, ku tokat produktive kthehen në moçal për shkak të mungesës së kullimit.

**Po te kulturat që mbillen apo nuk mbillen më, si ka ndikuar ky aspekt? A kemi kultura bujqësore, të cilat për shkak të kushteve të reja nuk janë më me prodhimtari të lartë apo nuk përshtaten?**

Po të shohim me kujdes në bujqësi, ne kemi reduktuar të gjithë kulturat industriale. Kemi reduktuar sipërfaqen e duhanit, jemi në minimum të kultivimit të lulediellit. Këto

djerrë. Foragjeret për blegtorinë janë braktisur pasi janë të lidhura me ujtitjen. Për shembull, misri kërkon shumë ujë dhe ka kosto të lartë ndaj është braktisur dhe importohet, por dikur ai ka qenë rentabël. Duhani, nga ana tjetër, ka vetëm pak kultivim në Shkodër dhe Elbasan. Është një kulturë që kërkon profesionalizëm, toka të veçanta dhe treg.

**Çfarë masash mund të merren për të ulur sadopak ndikimet negative që mund të vijnë si rrjedhojë e ndryshimeve klimatike në bujqësi?**

E para duhen certifikatat e pronësisë, që toka të shkojë tek pronari i vërtetë. Kjo është thelbësore për të nisur investimet për tokën. Duhet që ky 2,2% që bujqësia merr nga buxheti të dyfishohet pa humbur asnjë vit kohë. Ti jepet bujqësisë

“

**Rrapaj:**  
**Ndikimi i bujqësisë në ndryshimet klimatike. Po të shohim me kujdes në bujqësi, ne kemi reduktuar të gjithë kulturat industriale. Kemi reduktuar sipërfaqen e duhanit, jemi në minimum të kultivimit të lulediellit. Këto kanë qenë tradicionale për vendin. Hoqëm nga harta e prodhimeve, orizin.**

dhe gjithë zinxhirit ushqimor frymë. Duhet bërë vlerësimi i tokës. Kemi 20 vite që nuk bëjmë vlerësim, që të shohim dhe evidentojmë sa tokë është dëmtuar nga erozioni, çfarë perspektive ka ky fenomen në Shqipëri dhe të planifikojmë investimet për të përbaluar pasojat.

Shqipëria është i vetmi vend që nuk përpunon mbetjet në zonat rurale, por ato hidhen drejtpërdrejt siç degradohen në natyrë. Ne elementin bazë që kërkon toka, plehun organik, e importojmë dhe kjo shkon deri në 10 mijë tonë, kur ne, mund të ishim eksportues të mëdhenj të plehut organik duke pasur parasysh blegtorinë dhe gjithë mbetjet organike që kemi në Shqipëri.

**A ka sot një studim apo plan të mirëfilltë mbi tokën dhe pasojat që sjell indiferenca?**

Jo, nuk ka një program për

vlerësimin e tokës. Edhe Instituti i Tokës që ishte, u shkatërrua, por për mendimin tim duhet rikthyer dhe duhet fuqizuar më shumë sesa ka qenë. Duke pasur sipërfaqe bujqësore për frymë më të ulët në Europë, do na ndodhin probleme jashtëzakonisht të mëdha në zinxhirin ushqimor.

Nuk do kemi as agroturizëm, as blegtori, asnjë lloj zhvillimi të të gjitha hallkave të zinxhirit, pa vënë dorë në tokë dhe ujë. Kjo do të sjellë rritjen e vazhdueshme të importit, kosto të lartë të prodhimit, shtimin e tokës djerrë dhe lënien e saj në mëshirën e kushteve atmosferike. Çdo vend i botës në vendet e zhvilluara nuk i lë kullotat si tek ne, pa investim dhe shërbim. Nuk i lë pyjet pa asnjë lloj investimi për vite e vite të tëra.

Po kështu, kanalet vaditëse

dhe kulluese. Ndaj nëse nuk operojmë tek toka për ta mirëmbajtur për të reduktuar erozionin dhe për të realizuar qarkullimin bujqësor, i cili është shumë i rëndësishëm për pasurimin e saj. Ne jemi i vetmi vend, i cili nuk ka një ligj për siguracionet nga kushtet atmosferike, një kusht i domosdoshëm për të përbaluar pasojat që lënë ndikimet. Në shumë vende, pasojat jo vetëm kompensohen, por shteti është kontribues tek primi i sigurimit.

Mungesa e kësaj është një element negativ që ka ekzistuar dhe ekziston në dëmet, të cilat shkaktojnë kushtet e vështira atmosferike. Fatkeqësitë dhe fenomenet që dëmtojnë bujqësinë kanë ardhur nga viti në vit, duke u shtuar dhe nuk janë shoqëruar me kompensim. Dëmi ka ngelur në kurriz të fermerëve të cilët e kanë të pamundur ta kompensojnë atë.



## TEMA TË DITËS

# Krifca pret Salinas: Forcim dhe zgjerim të marrëdhënieve me BB

Banka Botërore është një partner i rëndësishëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca zhvilloi sot në ambientet e MB-ZHR, një takim me drejtuesin e zyrës së Bankës Botërore në Shqipëri, Emanuel Salinas dhe ekipin e tij.

Krifca u shpreh se gjatë takimit palët u angazhuan për të forcuar dhe zgjeruar marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Bankës Botërore.

“Banka Botërore është një partner i rëndësishëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Sot në Ministri morëm angazhim me drejtuesin për Shqipërinë,

Emanuel Salinas dhe ekipin e tij, të forcojmë dhe zgje-

jqësi, bujqësinë e të rinjve, ujitje e kullim, aksesin në fi-



rojmë këtë marrëdhënie për të ndërtuar më shumë punë e projekte zhvillimi në bu-

nancë, ekonominë blu dhe përmirësimin e zinxhirit të vlerës”, tha Krifca.

## Do të ngresh një bujtinë, fermë apo biznes në fshat? Veliaj prezanton nismën për gratë dhe vajzat e Tiranës

*Unioni i Bashkive Shqiptare të Rajonit vjen me projektin e radhës për fuqizimin e zonave në zonat rurale që nis nga fshatrat e Tiranës dhe do të shtrihet edhe në komunat e tjera në rajon, pjesë të Unionit.*

Unioni i Bashkive Shqiptare të Rajonit vjen me projektin e radhës për fuqizimin e zonave

edhe në komunat e tjera në rajon, pjesë të Unionit.

Kryetari i Bashkisë së Ti-

ngrejnë një bujtinë apo të hapin një biznes në fshat që të aplikojnë në këtë mundësi fantastike.

“Do të ngresh një bujtinë, fermë apo biznes në fshat? Unioni i Bashkive Shqiptare të Rajonit vjen me projektin e radhës. Nga Petrela, Bërzhitë, Farkë, Dajt, Shëngjergji, e gjer në Pezë. Bëhu pjesë edhe ti”, shkruan Veliaj.

Zonjat do të bëhen bashkë dhe do të asistohen nga projekti për ngritjen dhe zhvillimin e bujtinave dhe modeleve agroturistike në këtë zonë. Për t'u bërë pjesë e kësaj eksperience grate dhe vajzat do të duhet të kontaktojnë në adresën e emailit: [ubshr@tirana.al](mailto:ubshr@tirana.al).



në zonat rurale që nis nga fshatrat e Tiranës dhe do të shtrihet

ranës Erion Veliaj fton gratë dhe vajzat që dëshirojnë të

## Shpallet tenderi për tregun e prodhimeve bujqësore në Borsh - Detajet e projektit, që nga mbledhja e shitësve ambulantë e deri te fondi

Bashkia Himarë ka shpallur tenderin për ndërtimin e qendrës së tregut të prodhimeve bujqësore në Borsh. Fondi i

“Ky objekt do të grumbullojë shitësit ambulant, do të ulë problematikat e gjetjes së vendeve të shitjes dhe do

dhe jo rezident, turistët do të mund të kenë një vend ku të shohin produktet e larmishme vendase me çmimet përkatëse” specifikohet në detajet bashkangjitur projektit.

Funksionet kryesore që të tregut, referuar të dhënave të projektit, janë ndërhyrja në blerjen e produkteve bujqësore, për t'i magazinuar ose për t'i shitur me synimin që të arrijë stabilizimin e çmimeve të produkteve bujqësore e blegtorale, akumulimi i rezervave të tepërta të produkteve bujqësore e blegtorale dhe menaxhimi i tyre, mbështetja e tregtarëve që merren me tregtimin e produkteve që vijnë nga bujqësia.

Afati kohor për ekzekutim është 3 muaj, që nga nënshkrimi i kontratës me subjektin fitues.



vënë në dispozicion të projektit është 8.3 milionë lekë.

të rregullojë çmimet e tregut. Gjithashtu, banorët rezident

# Festa e Mjaltit në Librazhd, Balla: Nxjerr në pah produktin, ndër më tipikët e zonës

Librazhdi është prodhuesi më i madh, por edhe më cilësor i mjaltit në vend.

Janë rreth 6 mijë koshere në të gjithë territorin ku qindra fermerë vazhdojnë traditën e tyre në prodhimin e mjaltit.

Bashkia e Librazhdit organizoi sot “Festën e Mjaltit” dhe festivalin e Valles Dyshe në Breza.

Në këtë festë morën pjesë rreth 160 fermerë duke sjellë jo vetëm mjaltë cilësor, por edhe produkte të tjera bio të zonës.

Në aktivitetin e zhvilluar ishin të pranishëm deputeti i Partisë Socialiste, Taulant Balla dhe kryetari i bashkisë së Librazhdit, Kastriot Gurra.

Në fjalën e tij Balla tha se përveç panairit të mjaltit, sot është dhe festa e valles dyshe që është po ashtu mjalti artistik i zonës.

“Përgëzoj bashkinë e Librazhdit për vijimin e kësaj experience të shkëlqyer që nxjerr në pah një prej produkteve më tipike të zonës së Librazhdit. Përveç panairit të mjaltit, sot është dhe festa e valles dyshe që është po ashtu mjalti artistik i zonës sonë. Ne kemi krijuar një traditë shumëvjeçare tashmë, ku

nga të gjitha trevat shqiptare vijnë në Librazhd, për të ndjekur festivalin e valles dyshe. Obligimi im si djalë dhe

promovuar edhe produkte të tjera që prodhohen në Librazhd, siç janë patatet e Stërblevës, produktet e bulmetit,



deputet i kësaj zone është që ta forcojmë këtë traditë dhe ndoshta që prej vitit të ardhshëm, të mos jetë një ditë panairi, por të jetë një fundjavë e plotë”, theksoi Balla.

Nga ana e tij, kryetari i bashkisë së Librazhdit, Kastriot Gurra tha: “Ne mendojmë se mjalti është një nga produktet më të mira që bashkia Librazhd prodhon për shkak të terrenit”.

“Janë disa varietete që prodhohen në këtë zonë dhe kjo ka ndikuar edhe për të

që për shkak të terrenit që kemi janë produkte që kërkojnë shumë në treg, por ishte e nevojshme që bashkia të bënte promovimin e tyre”, tha ai.

Po ashtu, Gurra tha: “Jemi në kryerje e sipër të një premtimi që kemi bërë që në 2013-n, për ndërtimin e një pike grumbullimi që do ta realizojmë vitin e ardhshëm, në mënyrë që të gjitha produktet që prodhohen në Librazhd, të magazinohen dhe të shiten në treg, jo vetëm në Shqipëri por edhe më gjerë”.

## Pesticide pa limit - Makutëria e tregtarëve dhe padituria e fermerit bombardon me helme konsumatorin

*Përdorimi i pesticideve në bujqësi është një e keqe e domosdoshme për të ruajtur prodhimin bujqësor. Nuk është gjithnjë faji i fermerëve që frutat dhe perimet mbingarkohen me pesticide të rrezikshme*

Sipas një investigimi të “Qendrës Alert”, pesticidet e lejuar në vendin tonë janë

herë më të vogla seç janë deklaruar në etiketë. Çfarë sjell kjo? Së pari dëm për fermerin,

përballë kësaj situata si pasojë fermeri dëmtohet ekonomikisht, ndërsa konsumatori ushqehet me perime që kanë mbingarkesë helmesh. Qendra Alert thotë se konsumatori shqiptar blen çdo ditë domate dhe kastravecë me pesticide deri në 6 herë mbi normat e lejuara.

“Në lidhje me perimet ne kemi analizuar 5 mostra për 480 lloje pesticidesh dhe fatkeqësisht ato produkte që i konsumojmë më shumë që janë domatja, kastraveci ka rezultuar disa herë më të ngarkuar me pesticide seç është norma e lejuar. Imagjinoni kur në vendet e BE kapen perime të mbingarkuara me pesticide, si mund të jenë produktet që konsumojmë ne në Shqipëri, pasi grosistët për eksport zgjedhin ato produkte që pretendojnë se kanë cilësi.”

Ministria e Bujqësisë duhet të lëshojë alarmin për rrezikun e shëndetit të konsumatorëve, pasi mospërputhja e lëndës aktive me deklarimin në etiketë dhe pesticidit, bën që fermerët të përdorin mbidoza të helmeve dhe që në fund hyjnë në trupin tonë nëpërmjet perimeve.



jashtë standardit. Spërkatja e perimeve në serra me këto pesticide që duhet të luftojnë sëmundjet e bimës, në shumë raste nuk rezultojnë produktive. Për pasojë fermerët detyrohen të spërkasin prodhimin e tyre bujqësor disa herë me helmet të rrezikshme.

“Kemi analizuar 4 mostrash pesticidesh të ndryshme të marra në farmaci bujqësore. Dy prej 4 mostrave kanë rezultuar me lëndë aktive shumë

sepe referuar lëndës aktive të deklaruar në etiketë ai hedh dozën e duhur në fermë dhe sjell prodhim më të ulët. E dyta duke mos rezultuar efikas ky pesticide, fermerët shtojnë dozën që do të thotë se kur shtohet doza produkti është më i rrezikuar që të vij tek ne konsumatorët i ngarkuar me pesticide.”

Tregtarët e mëdhenj të preparateve bujqësore që kërkojnë të shtojnë fitimin e tyre, shesin pesticide jashtë standardit,



## AKTUALITET

# Shqipëria dhe Izraeli heqin taksimin e dyfishtë, nxitje investimeve

Shqipëria dhe Izraeli bien dakord për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat për individët dhe bizneset.

Konventa pritet të luajë rol të rëndësishëm në nxitjen e marrëdhënieve ekonomiko-tregtare mes dy vendeve.

Rëndësia e këtyre konventave po rritet vazhdimisht në kushtet e rritjes së aktiviteteve të biznesit të shoqërive shumëkombëshe dhe në kushtet e rritjes së vazhdueshme të lëvizjes së lirë ndërkombëtare të njerëzve, kapitaleve, mallrave e parave.

Projektligji për ratifikimin e konventës, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së

Shqipërisë dhe qeverisë së Izraelit për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat ka mbërritur për shqyrtim në Kuvend.

Konventa krijon një bazë të plotë ligjore për trajtimin tatimor të individëve apo personave juridikë shqiptarë apo të Izraelit, të cilët kanë aktivitete biznesi apo të ardhura të tjera që bien nën juridiksionin e legjislacioneve tatimore të të dyja shteteve.

Duke pasur aktivitet në të dyja shtetet apo duke qenë resident i njërit shtet, që siguron të ardhura në shtetin tjetër, individ apo personi juridik mund të rëndohet me tatim të dyfishtë (për të njëjtën të ardhur të tato-

het dy herë) gjë që mund të krijojë premisa për shmangie të tatimit dhe evazion fiskal.

Kjo konventë, dispozitat e së cilës kanë përparësi ndaj legjislacioneve tatimore të të dyja vendeve, trajton pikërisht faktin se si do të shmanget taksimi i dyfishtë, duke i dhënë të drejtën për taksimin e të ardhurave të caktuara vetëm njërit shtet apo duke e ndarë këtë të drejtë midis të dyja shteteve, por pa e rënduar subjektin me tatim të dyfishtë.

Konventa, gjithashtu, ka dispozita, në bazë të të cilave shtetet shkëmbejnë informacione dhe bashkëpunojnë për parandalimin e evazionit fiskal nga subjektet që kanë aktivitet në të dyja vendet.

## Standardi GlobalG.A.P në fruta-perimet “Made in Albania”, krijohet grupi teknik

*Fermerët interes të shtuar për certifikimin me GlobalGAP të produkteve*

KASH ka filluar të japë informacion për fermerët që duan të certifikojnë produktet e tyre, pasi një staf i KASH është trajnuar nga Akademia GlobalG.A.P me mbështetjen e RisiAlbania.



Krijohet grupi i parë teknik kombëtar i punës për GlobalG.A.P në Shqipëri me qëllim mbështetjen e zhvillimit e standardeve për zgjerimin e eksporteve bujqësore shqiptare.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Albinspekt bio. inspeksion dhe me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, ka ndërmarrë iniciativën për krijimin e grupit teknik kombëtar të punës për implementimin e standardit GlobalG.A.P në fruta perimet “Made in Albania”.

Zv.ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Emira Gjeçi e pranishme në takimin që zhvilloi sot në Tiranë grupi i punës, tha se ” GlobalG.A.P është një nga standardet më të kërkuara nga tregjet e Bashkimit Europian dhe më gjerë”. “GlobalG.A.P në Shqipëri, të inkurajojë dhe mbështesë aktorët e përfshirë nëpërmjet përshatjes së kërkesave të standardit GlobalG.A.P. me kushtet lokale të Shqipërisë si dhe të jetë një burim informacioni i vlefshëm rreth

këtij standardi që është pasaportë për eksportet bujqësore në tregjet ndërkombëtare”, u shpreh Gjeçi.

Grupi teknik i punës përbëhet nga 9 anëtarë: ekspor-

vendeve fqinje dhe platformën që ofron GlobalG.A.P. Kjo do t'i shërbente përmirësimit të sigurisë ushqimore në sektorin e fruta-perimeve dhe rritjen e standardeve drejt Bashkimit Europian.

Gjithashtu në takimin e grupit teknik të punës GlobalG.A.P, kreu i KASH Agim Rrapaj prezantoi kërkesën adresuar MBZHR në lidhje me amendimin e VKM nr. 100 date 05.02.2020 për mbështetjen dhe masën e financimit të njësive të certifikuara sipas standardit GlobalG.A.P. ku ndër të tjera theksoi rëndësinë e mbështetjes për certifikimin në grup si një model i qëndrueshëm dhe i përshtatshëm për strukturën e bujqësisë në Shqipëri.

Sot eksportet bujqësore shqiptare shkojnë në 75 vende të botës. Eksportet bujqësore, në



dhe shoqata të agrobiznesit.

Ky grup synon të adresojë disa çështje të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të standardit.

Në këtë takim i përfaqësuesi i grupit teknik kombëtar të punës shpjegoi objektivat e këtij grupi vullnetar të punës dhe punën e deritanishme.

Në takim u diskutua dhe mundësia që në të ardhmen Shqipëria të ketë një standard lokal bazuar në eksperiencën e

total janë rritur nga rreth 100 milionë dollarë në fund të vitit 2014 në 400 milionë dollarë në fund të vitit 2020, ndërsa parashikohet të shkojnë në mbi 1 miliard në katër vitet e ardhshme.

Sektori i bujqësisë është ndër sektorët me kontributin më të madh në Prodhimin e Brendshëm Bruto, rreth 20 %. Në Shqipëri në vitin 2013 punoheshin afro 125 mijë ha tokë, ndërsa sot punohen 250 mijë ha tokë.

## “Çmimet e nënprodukteve të grurit do të vijnë në rritje”

Flet Adi Haxhiymeri, kreu i Shoqatës së Prodhuesve të Miellit

*Duhet të mësohemi, që të paktën në vitet e ardhshme, çmimet do të shënojnë rritje. Kjo rritje fatkeqësisht, nuk është vetëm në artikullin e ndjeshëm siç është mielli, por edhe në të gjitha produktet e tjera. Dhe çmimi i bukës, ndikohet jo vetëm nga çmimi i miellit, por edhe përbërësit e tjerë si çmimi i vajit, ambalazhet. Të gjitha këto bashkë, kanë efektet e veta.*

*Prej disa javësh, disa biznese në vend kanë rritur çmimin e bukës me 10 lekë. Arsyeja kryesore raportohet të jetë rritja e çmimit të miellit në tregun vendas me 5 lekë/kg që në fillim të muajit gusht. Sipas kreut të Shoqatës së Prodhuesve të Miellit, z. Adi Haxhiymeri, një rol të rëndësishëm ka luajtur rritja e çmimit të grurit në bursë*

**Cilat janë arsyet që kanë nxitur rritjen e çmimit të bukës në vend?**

Që të mos flas specifikisht vetëm për rritjen e çmimit të bukës, duke qenë se është një biznes që nuk e zotëroj, por në një analizë më të gjerë, një nga arsyet mbetet rritja e çmimit të grurit në bursa ndërkombëtare.



Dihet që Shqipëria është e varur tërësisht nga furnizimi i importit, vetëm një sasi fare e vogël prodhohet në tregun tonë. Ndaj, automatikisht me lëvizjen e çmimit të bursës, lëviz e çmimi i miellit.

Çmimi i grurit vazhdon të rritet prej kohësh, ne e kemi theksuar. Duke iu referuar shifrave, po të marrim tetorin e vitit të kaluar, çmimi i grurit ishte 240 dollarë/ton, ndërsa aktualisht po merret me 350 dollarë/ton. Kjo është një rritje shumë e madhe. Rritjen fillestare e ka pasur në fund të vitit të kaluar, në periudhën dhjetor-janar, por kjo u reflektua shumë pak në rritjen e çmimit të miellit për arsye se, rezervat ishin më të mëdha, konkurrenca sigurisht luan rolin e vet, çmimi i miellit u rrit shumë pak dhe nuk pati nevojë të reflektohej në çmimin e bukës. Aktualisht, rritja ndodhi pikërisht në momentin kur mbaruan korret.

**Cilët janë arsyet e rritjes të çmimit të grurit në bursa?**

Kompanitë, kudo në botë, kanë minimumin e rezervave, për arsye se, bëhen gati për furnizimet e reja dhe kjo është një logjikë që ndiqet çdo vit. Mirëpo, sivjet, për arsye të faktorëve klimatikë, nxehtësisë së madhe, vendet kryesore që eksportojnë grurë në botë – Rusia, SHBA, Kanada, Australia

– patën shumë probleme në drejtim të prodhimit të grurit.

Vetëm tre shtetet e para të përmendura kanë një rezultat minimal, me rreth 20 milionë tonë grurë më pak. Kësaj situatë, po t'i shtojmë dhe deficitet të tjera që patën shtete si Gjermania, Franca, që patën probleme edhe me përmbajtjet, përveçse me thatësinë, kjo nisi të ndihet jashtëzakonisht shumë. Kërkesa për grurë nga viti në vit, vjen duke u rritur. Jo vetëm për grurë, Kina është një ndër shtetet që ka nisur të shtojë nga viti në vit sasi të grurit, misrit, sojën etj. Të gjithë këta faktorë krijuan një deficit në bilancin e përgjithshëm të prodhimit të grurit, dhe automatikisht çmimi i grurit u

brendshëm, të mos krijohen tensione të cilat janë krijuar në të gjithë vendet e botës.

Problemi i grurit nuk është thjesht në grurin e butë, i cili përdoret për produkte që lidhen me bukën ose byrekun/picën etj. Rritje absurde ka pasur edhe gruri i fortë, është rritur si asnjëherë tjetër 100%. Kjo erdhi sepse shtete që eksportojnë grurin e fortë, si Kanadaja, kanë prodhuar më pak. P.sh. nga 6.5 milionë tonë/vit, ka prodhuar gjysmën. Gjithashtu, Franca ka prodhuar 40% më pak. Problemet që patën, u reflektuan në prodhimin e makaronave, një ndër shtetet i cili po e vuan më shumë është Italia, si prodhues dhe eksportuesi më i madh në botë i makaronave. Edhe makaronat do të shënojnë rritje graduale të çmimit në vijim. Sa më shumë i afrohem fundit të vitit, aq më i lartë do të jetë çmimi.

**A ka pasoja në treg nga importet e miellit pa standarde, shqetësim të cilin ju e keni ngritur më parë?**

Ky është një problem prej dekadash në Shqipëri, por në dijeninë time është forcuar më tepër kontrolli në pikat doganore, nuk ka informacione të fundit në këtë drejtim që sinjalizon ndonjë problematikë aktuale. Duhet thënë se kriza e këtij produkti është kudo, jo vetëm në Shqipëri. Rritja e çmimit të bukës ka ndodhur jo vetëm në rajonin tonë, por edhe në të gjitha shtetet importuese të këtij produkti.

**Zoti Haxhiymeri, çfarë masash duhen marrë nga qeveria shqiptare për ta bërë industrinë më konkurruese?**

Është shumë e lehtë të japësh mendim për këtë gjë. Mendoj se masa që kanë efekt në buxhetin e shtetit, është e vështirë t'i marrësh në këtë moment, sepse jemi në fund të vitit. Mund të parashikohet diçka në buxhetin e vitit të ardhshëm, ku me rastin e fiskalizimit mendoj se do të ketë rritje të ardhurash vendi, n.q.s. do të realizohet siç duhet.

Ndaj, në këtë drejtim, duke pasur parasysh që mund të kemi rritje të ardhurash, mund të bëhet një diferencim në lëndët e para të artikujve të shportës. Sepse mbajtja 20% e TVSh-së, për të gjitha llojet e produkteve, edhe për lëndët e para, edhe për produkte jo të domosdoshme për jetesën e njerëzve, krijon problem. Por ky është problem më i gjerë, ne e kemi ngritur si shqetësim edhe në takime me palë si FMN-ja. Mendoj se ka rëndësi shumë sasia e taksave

(Vijon në faqen 7)



## BUJQËSI

(Vijon nga gazeta paraardhëse)

## Mekanizmat, reformat dhe mikroreformat, të cilat çojnë drejt “Bujqësisë së Gjelbër”

Prof. Ass. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, Durrës

Pjesa dytë e artikullit

*Në shkrimin e parë u trajtuan, parime, koncepte dhe ide, të cilat janë shprehur për t'i kuptuar një masë sa më e madhe lexuesish, duke përfshirë edhe konsumatorët. Zhvillimin e çdo biznesi e përcakton niveli i konsumatorit. Kemi për detyrë të qartësojmë konsumatorët, që ata të jenë opozitarë me të gjithë, që nga shkenca, prodhuesit e deri te qeveria vendore dhe qendrore. Për shumicën e lexuesve, të cilët nuk janë familjarizuar me temin “Bujqësi e Gjelbër”, do të ishte e arsyeshme të qartësojmë se çfarë është ky term “I GJELBËR”*

caktuar. Në këtë kuptim sistemet e prodhimit kanë karakter historik, si për çdo vend, ashtu

Global GAP (Good Agriculture Practices )

- Sistemi i bujqësisë biologjike/organike/ekologjike (pra këto terma janë sinonime). Ky sistem përdor inpute të provuara miqësore. Në vitin 2020, Parlamenti Europian mori një vendim historik, deri në vitin 2030, bujqësia bio do të katërfishohet, nga 8,5 % që është sot, të arrijë 25 % të sipërfaqes së përgjithshme bujqësore, brenda vendeve anëtare të BE-s në Ballkan. Bujqësia bio zë rreth 1,5 %, ndërsa në Shqipëri nën 1 %. Në këtë kuadër Europa e zhvilluar ka shpallur iniciativën me një “Green Europë”, pra për një Europë të Gjelbër.

Cili duhet të jetë sistemi i duhur i bujqësisë edhe për Shqipërinë?

- Duhet ecur në paksimin e përvitshëm të bujqësisë konvencionale dhe duhet kaluar gradualisht në sistemet e bujqësisë së integruar, në Standartin Global GAP dhe në sistemin më të sigurtë, i cili është sistemi që respekton standartin biologjik. Të gjithë këto sisteme përfaqësojnë “bujqësinë e qëndrueshme”.

## 2. Focimi i shkencës bujqësore dhe rinovimi i stafëve

Shkenca bujqësore duhet të ketë një strategji integrimi mes Universitetit të Bujqësisë, Instituteve shkencore të nivelit të dytë (që sot quhen QTTB) dhe shkencës së zbatuar në nivel ferma, pra i kërkimeve në fermë.

Në këtë kuadër duhet të hiqet dorë nga prodhimi i studentëve të bujqësisë në sasi, por përparësi të jetë cilësia e studentëve të bujqësisë.

Si shpjegohet që kaq shumë studentë që mbarojnë çdo vit Universitetin e Bujqësisë dhe sa pak agronome dhe agronomë të rinj shikojmë në fushat e prodhimit dhe në institucionet shkencore të nivelit të dytë?

Mendoj se sigurimin e një elite cilësore studentësh duhet marrë në dorë nga Shteti dhe Universiteti. Për këto studentë të ketë programe më të avancuara, të kryejnë punë shkencore dhe të bëjnë vizita të organizuara në vendet e Europiane. Këta studentë të kenë edhe disa mbështetje financiare, për t'i dalluar nga studentët e zakonshëm. Me këto studentë shteti paraprakisht bën një kontratë për vendet e punës, por edhe një kontratë që ata të kontribuojnë të paktën 3-4 vjet, pa u larguar nga vendi. Pas kësaj periudhe të jenë të lirë të shkojnë të punësohen kudo në Europë. Një skemë e tillë e me-

naxhimit të studentëve cilësorë, bën që të mos boshatiset vendi nga ekspertët e nivelit të lartë profesional.

## 3. Shërbimi Këshillimor Shtetëror

Vazhdon të operojë me konceptet e viteve para 1990. Investimet për trajnimin e rrjetit të shërbimit këshillimor, investimet për infrastrukturën dhe logjistikën e këtij shërbimi janë në situatë të dobët dhe nuk përballojnë kërkesat e sotme të bujqësisë moderne, e cila shoqërohet me shumë navatorizma dhe teknologji të komplikuara.

Me studentët cilësorë që përmendëm më sipër duhet rinovuar me agronomë të rinj pjesa më e madhe e ekspertizës në shërbimin këshillimor publik, ose edhe ato që do të dëshironin të shërbenin në shërbimin këshillimor privat.

Në këtë kuadër, shteti duhet të përdorë për qëllimet e politikave bujqësore edhe rrjetin e shoqatave dhe instituteve private dhe ato jo qeveritare. T'i mbështesë ato me fonde, sepse janë stafë të kualifikuara dhe kanë punuar prej vitesh me ekspertë të huaj në zbatim të projekteve të ndryshme.

## 4. Farërat dhe fidanat

Jo gjithmonë tregut i ofrohen farëra me cilësi të mira agronomike dhe teknologjike. Ka shumë kultivarë të importuar, shija e të cilave nuk pëlqehet nga konsumatorët.

Nuk i vihet rëndësi të blihen kultivarë tolerantë ose rezistentë ndaj sëmundjeve, insekteve dhe metodave. Duhet të organizohen panel teste për shijen dhe vlerat e kultivarëve që hidhen në treg.

Në koleksionet tona, ka shumë nga kultivarët e mollëve dhe hardhive, të primeve, të cilët janë rezistent ndaj sëmundjeve, por nuk ka politika që të nxisin përdorimin gjithnjë e më shumë kultivarë të tilla. Kultivarë rezistentë ose tolerantë ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesëve kryesorë, do të kufizonin dukshëm përdorimin e PMB-ve (pesticideve) në bujqësi.

Sistemi i certifikimit të fidanave në pemë frutore, ullishte dhe vreshta, nuk është i mirëorganizuar. Kontrolli i fidanave të mbjellë, është shumë i dobët dhe kjo sjell pasoja ekonomike dhe mjedisore për sot dhe për më vonë.

## 5. Menaxhimi i tokës

Dëmin më të madh këto tre dekadat e fundit, ia kemi shkaktuar tokës bujqësore dhe

jashtë saj.

Përveç dëmeve të mëdha që ka shkaktuar urbanizimi pa kriter, i pallogjorizim është dëmi i erozionit (grryerjes së tokës), nga mungesa e investimeve të cilat parandalojnë gërryerjen e tokës.

Me qinda dhe me mijëra hektarë janë dëmtuar fizikisht nga gërryerja. Ky është çënimi më i madh i sigurisë kombëtare. Nuk kam parë deri më sot ndonjë strategji të bujqësisë, e cila të ketë parashikuar fonde të pranueshme për parandalimin e grryerjes së tokës dhe mbrojtjen fizike të saj.

Shteti mendoj se duhet të japë alarmin në mobilizimin e çdo shqiptari për të shpëtuar dëmtimin fizik të tokës. Ky alarm nuk po ndihet, ndonëse mediaelektronike dhe shkruar, sytë tanë të përditshëm ka afruar argumenta me zë dhe figurë, se çfarë po i sjell erozioni tokës sonë bujqësore. Instucionet shkencore duhet gjithashtu t'i bëjnë një “skanër” mbetjeve kimike në tokat tona, sidomos në ato të prodhimit intensiv, si në vreshta dhe mollës dhe në perimet në serra. Nuk mendoj se jemi në alarm për ndotjen e tokës, por na duhet ta njohim gjendjen që të ndërhyjmë në kohë me metoda shkencore për shëndoshjen e saj.

## 6. Përzgjedhja dhe mirëpërdorimi i inputeve

Inputet, cilësia e tyre dhe përdorimi profesional, përcaktojnë në një farë mënyre vetë sistemin e bujqësisë që zbatojmë.

Në vendin tonë është bërë kujdes për të regjistruar plehra, PMB dhe farëra me cilësi të pranueshme. Mendoj se herëpashere listat e inputeve duhen riparë. Një pjesë duhet të dalin nga përdorimi, të tjerë inpute miqësore me mjedisin duhet të regjistrohen.

Gabimet më të mëdha në lidhje me inputet na vijnë nga përdorimi jo profesional i tyre.

## Kjo vjen për disa arsye.

Së pari niveli profesional i fermerëve është i ulët, ku shumica janë të patrajtuar.

Së dyti, Shërbimi Këshillimor Shtetëror, nuk i njeh në detaje vlerat dhe antivlerat të secilit input që përdoret në bujqësi.

Së treti, shkallë e ulët e mekanizimit të shpërndarjes së plehrave, PMB-ve dhe farërave.

## Si duhet gjykuar mbështetja e shtetit në heqjen e tarifave doganore për inputet?

Është mirëpritur heqja e

tarifave doganore, për inputet, por ky vendim për mua kërkon disa korrigjime.

Unë mendoj se duhet të mbështeten vetëm lista e inputeve miqësore me mjedisin dhe jo çdo lloj plehu dhe produkti për mbrojtjen e bimëve.

Kjo ka bërë që tregtarët të prirën të sjellin në treg edhe inpute me cilësi të ulët, sepse i blejnë më lirë. Natyrisht shumica e inputeve janë brenda standarteve të kohës. Si mund të ketë të njëjtën mbështetje financiare si për insekticidin Rogor (Bi58 /Dimethoat), me feromonet Eko-Trape që përdoren të dy për mbrojtjen e ullirit nga miza?

Pra mendoj se duhen mbështetur finaciarisht nga shteti, inputet, të cilat lejojnë të përdoren në bujqësinë biologjike dhe në bujqësinë e integruar. Farërat, po, mund të lejojnë të mbështeten edhe nga mekanizmat doganore. Po kështu edhe plehrat me cilësi të mira dhe mekanika po se po, të mbështeten, por jo inputet me cilësi të dobëta mjedisore dhe me ndikime negative në shëndetin e njerëzve dhe larminë biologjike (biodiversitetin) në përgjithësi.

## 7. Standardet në bujqësi

Bujqësia jonë duhet të orientohet vetëm drejtë bujqësisë së certifikuar.

Kjo do të thotë që të jenë në zbatim standartet e Global GAP, HASAP (standarti higjenës) standardet e familjes “ISO” dhe standarti më i lartë, ai i bujqësisë biologjike.

Në vendin tonë të gjithë këto standardet njihen, sepse një numër fermash dhe njësi përpunimi i kanë zbatuar këto standarde dhe janë certifikuar me to.

Duhet të theksojmë se me standarde të tilla është e certifikuar vetëm rreth 1% e bujqësisë shqiptare. Pra ndonëse Shqipëria ende prodhon produkte bujqësore cilësore, por pjesa e certifikuar është shumë e vogël. Standardet e certifikimit janë rregulla loje që të detyrojnë të ecësh në rrugën më të drejtë dhe afatgjatë. Standardet na çojnë, ose na detyrojnë të përmirësojmë të gjithë zinxhirin që nga njohuritë e deri në organizimin e fermave. Shteti është si FIFA, e cila përsos rregulloret e lojës dhe nuk i intereson se bëjnë apo nuk bëjnë stërvitje ekipet sportive.

“Sistemi “VAR”, e vendos shoqërinë në rrugë të mbarë”. Këto në rastin e prodhimit bujqësore dhe blegtorale, janë standardet. Ne po e shikojmë se edhe në shoqërinë tonë reformat më të vështira po na duken reformat në drejtësi, të cilat në fakt pasqyrojnë standartin e shoqërisë sonë.

Shkurt, na duhet të përballemi edhe me pengesat që na dalin për të shmangur prodhimin pa standarde. A mundet të jenë standardet krejt vullnetare?

(Vijon në faqen 10)



thjesht biofabrikë e qumështit dhe mishit. Lopa nuk prodhon as barë, as jonxhë, as sojë, as misër. Lopa vetëm përpunon ushqimet që merr në natyrë.

Kështu, njeriu në fabrika përpunon sheqerin e panxharit të sheqerit, vajin e ullirit i prodhuar nga gjethet e gjelbëra të ullirit, rrushin e prodhojnë gjethet e rrushit e me radhë.

Shkurt, gjethi është e vetmja fabrikë, transparente, pa hile, pa manipulime. Ajo prodhon edhe pa inputet e industrisë. Është kjo arsye që një bujqësi e ndershme merr emrin e ngjyrës së gjethes «e gjelbër». Bujqësia duhet ta ngajë pikërisht gjethit të gjelbër, e cili ka miliona vjet që prodhon produkte organike.

Më poshtë po rreshtojmë mekanizmat reformat dhe minireformat, të cilat duhet të zbatojmë që bujqësi atë quhet «Bujqësi e Gjelbër».

Për lexuesit të cilët nuk janë familjarizuar me termin “Bujqësi e Gjelbër”, ose më gjerë “Ekonomi e Gjelbër”. Pse nuk e quajmë p.sh. “Bujqësi e Verdhë”, Bujqësi Blu», etj.?

## 1. Zgjedhja e sistemeve të bujqësisë, të cilët krijojnë siguri shëndetësore dhe mjedisore

Ka disa sisteme bujqësie, të cilët që janë në zbatim praktik. Para së gjithash duhet të jemi në një mendje se cili është një sistem bujqësie dhe cilat elementë i dallon ato nga njëri tjetri. Me sistem bujqësie kuptojmë tërësinë e praktikave bujqësore, teknikave dhe teknologjive në një periudhë të

edhe në shkallë botërore.

“Sistemi më i përhapur në botë është sistemi i bujqësisë, i cili përdor në sasira të pakta të inputeve. Në literaturë këtë sistem e gjejmë me shkurtime LEIA (Low External Input Agriculture), pra përdor sasira të pakta inputesh që vijnë e blihen jashtë fermës. Me fjalë të thjeshta këtu futen fermat që përdorin pak kilogram plehra kimike për hektarë dhe pak trajtime kimike. Kjo në shumicën e rasteve vjen nga pamundësia për të investuar në bujqësi, si dhe nga dëshira për të mos përdorur shumë kimizim në bujqësi.

- Sistemi i bujqësisë konvencionale, ose të zakonshme, e cila përdor sasira të mëdha inputesh për njësinë e sipërfaqes (plehra, produkte për mbrojtjen e bimëve, që këto të fundit në publik njihen me termin “pesticide”. Ky sistem, i jep përparësi prodhimit dhe fitimit dhe nuk fokusohet shumë në pasojat në mjedis.

- Bujqësia e integruar, e cila i përdor inputet me kriterë me shkencore, duke futur edhe elementë të tillë, si qarkullimin bujqësor, kultivarët rezistentë, ose tolerantë ndaj sëmundjeve, përdorimin e plehrave dhe produkteve të mbrojtjes së bimëve me cilësi më të mirë, ruan higjenën e mjedisit etj. Ky sistem është shumë më i pranueshëm, se sa sistemi konvencional. Ky sistem dominon në botën e zhvilluar.

- Bujqësia e përfshirë në standartet Praktikave të Mira Bujqësore Globale e quajtur



## INFORMACIONE

# Gazeta “Agrobiznesi”, më shumë informacion për mbështetjet që ofron RisiAlbania

Certifikimi GlobalGA.P. është një nga iniciativat që po tërheq gjithmonë e më shumë fermerët shqiptarë. Përmes certifikimit synohet arritja e një standardi të vërtetë sigurie për konsumatorët, për të siguruar transparencën e prodhimeve dhe më shumë besim për produktet që konsumojmë.

Synohet mbi të gjitha praktikatat e sigurta dhe afatgjata për të gjitha produktet bujqësore.

Certifikimi GlobalGA.P. është një nga temat e trajtuara shumë herë në gazetën “Agrobiznesi”, ku edhe në sajë të mbështetjes së dhënë fermerëve nga projekti “RisiAlbania”, jemi përpjekur të informojmë sa më shumë fermerët mbi të mirat që sjell certifikimi.

Stafi i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, në sajë të informacioneve të publikuara dhe shembujve të suksesit të paraqitur në gazetën “Agrobiznesi”, është kontaktuar nga shumë fermerë të cilët kanë shprehur interesin e tyre dhe kanë kërkuar informacion dhe udhëzime për të arritur certifikimin e produkteve të tyre.

Gazeta “Agrobiznesi” mbi dy dekada në treg, është e para dhe e vetmja gazetë infomative bujqësore në hapësirën shqiptare, me mbi 15 rubrika. Gazeta Agrobiznesi është në dispozicion të çdo informacioni që kanë nevojë fermerët, blegtorët, agrobiznesi, sipërmarrjet agroturistike, peshkatarët, tregtarët e inputeve bujqësore etj. Stafi i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar vazhdon çdo ditë të punojë me përkushtim për të njëjtin mission, të ofrojmë 360° informacion praktik dhe utilitar bujqësor për fermerët dhe tregun bujqësor.

## Fermerët në Malësinë e Madhe, interes për certifikimin e bimëve mjekësore me GlobalGA.P.

Sipërmarrës që operojnë në kultivimin dhe tregimin e bimëve mjekësore, përmes certifikimit me GlobalGA.P. të produkteve të tyre, po rrisin vlerën e eksporteve të bimëve mjekësore në tregjet e huaja.

Ludoviku nga Malësia e Madhe, krahas investimeve në kompaninë e tij “Muçaj” shpk, në teknologji të re përpunimi, po tregon interes edhe për certifikimin e prodhimeve me GlobalGA.P., me qëllim që arrijë të sjellë në treg një produkt cilësor të bimëve mjekësore të zonës, të cilat eksportohen në SHBA dhe Azi. Ludoviku tregon se sot janë mbi 400 fermerë, të cilët sjellin prodhimin e tyre në këtë kompani, duke iu mundësuar kështu treg për prodhimet e tyre. Certifikimi me GlobalGA.P. është garanci për eksporte të sigurta dhe vlerë e shtuar për ekonomitë e tyre.

Malësia e Madhe zë vendin e parë në vendin tonë, për sasinë e kultivimit, grumbullimit dhe

eksportit të bimëve mjekësore aromatike.

Kryetari i Bashkisë në Malësinë e Madhe, Tonin Marinaj, në një komunikim me stafin e gazetes agrobiznesi u shpreh i gatshëm për të bashkëpunuar me Këshillin e Agrobiznesit Shqiptar dhe projektin RisiAlbania, për të ndërmarrë iniciativë që i vijnë në ndihmë fermerëve të zonës për certifikimin me GlobalGA.P. të bimëve mjekësore që janë burimi kryesor i zhvillimit të ekonomisë së zonës.

Malaj solli në vëmendje shembullin e Dianës, një grua kurajoze e punëtore nga Malësia e Madhe, që ka hequr dorë nga emigrimi së bashku me bashkëshortin e saj, duke u përqëndruar te bujqësia, konkretisht te bimët medicinale.

Të dy besonin fort te zhvillimi i fshatit dhe ia dolën që dëshirën e tyre ta bënin realitet.

“E nisëm me 10 dynymë të mbjella me bimë aromatike mjekësore. Ecëm dalëngadalë në shtimin e sipërfaqeve duke marrë mbështetje edhe nga AZHBR, përmes Skemës Kombëtare”, na tregon Diana.

Sot ata kanë rreth 140 dynymë të mbjella me livando dhe sherbelë. Kanë të punësuar 15 persona të zonës dhe synojnë investime të mëtejshme në këtë fushë në drejtim të certifikimit të prodhimeve me standardet më të mira ashtu sikurse është GlobalGA.P..

Fermerët në të gjithë vendin po zgjerojnë sipërfaqet e tokave të mbjella me bimë mjekësore dhe aromatike, nga eksporti i të cilave sigurojnë të ardhura ekonomike më të larta. Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural bën të ditur se përmes mbështetjes financiare nga Skema Kombëtare në Bujqësi dhe programi IPARD II është rritur në 2080 ha sipërfaqja e mbjellë me bimë mjekësore dhe aromatike, në këto vitet e fundit.

Kërkesa në rritje e tregjeve të huaja për këto bimë, që sigurojnë edhe fitime më të mëdha për familjet fermere, i ka nxitur ata për t’u marrë me këtë aktivitet.

Kryetari Malaj thotë se krahas zgjerimit që po marrin edhe investimet në qendra të grumbullimit dhe përpunimit të këtyre bimëve, që bëjnë mbledhjen e të gjithë prodhimit nga fermerët dhe i eksportojnë ato jashtë vendit, paralelisht duhet të eci edhe mbështetja për certifikimin që ofrohet nga projekti RisiAlbania.

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural ka mbështetur 36 investime në 18 bashki të vendit për zhvillimin e sektorit të bimëve mjekësore.

10 prej këtyre investimeve janë startup-e që kanë hapur 555 vende pune të reja dhe kanë dhënë impakt në rritjen e të ardhurave familjare dhe rritjen e eksporteve.

Ndërsa Skema Kombëtare e Mbështetjes në Bujqësi dhe Zhvillimit Rural për vitin 2021,

financon deri në 100 mijë lekë fermerët që mbjellin bimë mjekësore e aromatike në vlerën 200 000 lekë për hektarë.

Në Shqipëri ka mbi 7 mijë lloje bimësh, të cilat formojnë thujse 32 % të të gjithë florës së Europës.

Eksporti i këtyre bimëve ka rritur të ardhurat për familjet e zonës dhe ka nxitur punësimin.

Sektori i bimëve mjekësore dhe aromatike ka krijuar mundësi punësimi për rreth 100 mijë familje që jetojnë në zonat rurale të vendit. Ndërsa gjeneron rreth 18 milionë euro nga eksporti, i listuar si sektori i dytë më i madh në eksportin bujqësor.

Më 2020, Shqipëria ka eksportuar mbi 15.000 tonë bimë mjekësore dhe aromatike, me vlerë mbi 50 milionë euro

I tillë është edhe rasti i Bashkim Banushi nga Lushnja. Ai është një prodhues perimesh në serra. Ai punon fort për të prodhuar produkte sa më cilësore dhe certifikimin GlobalGA.P. e shikon si celësin për të rritur tregun e shitjeve të produkteve të tij.

Rritja e kërkesës për shitjen e produkteve do të shoqërohet me hapjen e vendeve të reja të punës dhe zhvillimin e sipërmarrjes së tij. Banushi thotë se, përmes certifikimit frutat dhe perimet shqiptare kanë të gjitha garancitë dhe përmbushin kërkesat e sigurisë dhe cilësisë për t’u eksportuar në supermarketet europiane.

Në kontakt të vazhdueshëm me KASH-in, ai është informuar se, certifikimi GlobalGA.P. është inovacion dhe përmirësim i vazhdueshëm i të gjitha hallkave të sektorit, përshtatje dhe standardizim gjithmonë në partneritet me të gjithë faktorët për të arritur standardet e kërkuara nga tregu.

Bashkim Banushi në sajë të informacioneve të dhëna nga Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar dhe mbështetjes së dhënë nga RisiAlbania, aspiron të nisi procedurat për plotësimin e të gjitha kriterëve të certifikimit.

Fermerët kanë shfaqur interes të veçantë për certifikimin në grup si një mënyrë për të arritur tregjet uropiane.

RisiAlbania, projekti i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, që zbatohet nga Helvetas Swiss Intercooperation dhe Partners Albania, po mbështet eksportuesit për të menaxhuar dhe për të marrë certifikimin në grup për fermerët e tyre furnizues.

Gjithashtu një tjetër fermer i interesuar për certifikimin me GlobalGAP të prodhimeve në fermën e tij është edhe Ramazan Veriku nga Fieri. Ai nuk është i vetmi nga qarku i Fierit që ka kontaktuar KASH dhe ka shfaqur interes, pasi janë të shumtë edhe fermerët e tjerë të cilët kanë kërkuar informacion dhe kontakte për procedurat dhe rrugën që ata duhet të ndjekin drejt certifikimit.

# Rritja e çmimit të bukës, Rama: Heqja e TVSH-së nuk do të sillte efekt

Kryeministri Edi Rama deklaroi se rritja e çmimit të bukës erdhi si rezultat i taksës së vendosur nga Rusia, që është edhe furnizuesi më i madh në Europë për eksportin e grurit dhe se heqja e TVSH-së nuk do të sillte efektin e uljes së çmimit për konsumatorët.

Gjatë një debati në një studio televizive, Rama tha se eksperiencat me uljen e TVSH-së për inputet bujqësore tregoi se nuk ka efekt domethënës në uljen e çmimit.

“Ne kemi eksperiencën me uljen e TVSH-së për inputet bujqësore. Pavarësisht se u zerua TVSH nuk është se pati ndonjë ndryshim domethënës të çmimit te produktet. Sepse kemi zgjedhur një sistem, i cili nuk funksionon mbi bazën e vullneteve të qeverive për të vendosur çmimet, por mbi bazën e tregut”, tha ai.

Rama foli edhe për rritjen e çmimit të bukës dhe tha se në këto 8 vite është rritur 3 herë.

“Çmimi i bukës në 8 vite është rritur 3 herë. Kjo vjen nga

fakti se furnizuesi më i madh në Europë i grurit që është Rusia ka vendosur një taksë eksporti. Kjo ka bërë që çmimi të rritet kudo. Këtë nuk mund ta ndalosh duke marrë masa, sepse lidhet drejtpërdrejtë me tregun. Edhe ulja e TVSH-së nuk ka sjellë edhe në vende të tjera rezultat në

Sipas Ramës janë fantazira mendimet se çmimet mund të vendosen.

“E mbani mend kur Lulzim Basha kur donte të kandidonte për Bashkinë e Tiranës shkronte dyqan më dyqan e deklaronte se do të ulte çmimin e bukës. Janë fantazi që funksionojnë për ata



uljen e çmimit. Ndikimi mund të ishte edhe më i madh”, shtoi kryeministri.

që kanë dëshirë t’i besojnë, por nuk kanë lidhje me sistemin që kemi zgjedhur”, deklaroi Rama.

# Standarde për eksport, fabrikat e përpunimit në Dibër asistohen nga ekspertët gjermanë

Fabrikat e përpunimit të perimeve në Dibër, janë një tjetër shembull domethënës i sipërmarrjeve private në vendin tonë, që po zhvillohen sipas modeleve më të mira bashkëkohore me

qëllim rritjen e eksporteve.

“Dy këshillime të dobishme nga ekspertët gjerman, (GIZ) me të dy përpunuesit aktualë të frutave në Dibër, për të përmirësuar teknologjitë e tyre,

u realizuan në shtator 2021”, njofton Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Në to u diskutua për cilësinë e frutave në vjelje dhe produktet ushqimore në afatin e ruajtjes. Përpunuesit u trajnuan për më shumë cilësi si edhe për shitjen në supermarkete nëpërmjet metodave të reja për të zgatur jetëgjatësinë dhe periudhën e marketingut.

Projekti gjerman SRD (GIZ) bën të ditur se, do të vazhdojë të mbështesë sektorin e frutave duke u fokusuar në përpjekjet e fermerëve dhe konsoliduesve për produktet e përpunuara të frutave të cilësisë më të lartë, me qëllim nxitjen e eksportit



# "Çmimet e nënprodukteve të grurit do të vijnë të rriten"

(Vijon nga faqja 5)

që një shtet mbledh në raport me PBB-në e vet, pra sa më e lartë përqindja e taksave në PBB e një shteti, aq më të ulëta logjikisht janë taksat.

Megjithatë, në rastin tonë, shteti duhet të fillojë ta programojë gradualisht, sidomos për vitin e ardhshëm, meqenëse mendohet se do jetë një vit i vështirë, sepse rritjet do të jenë kudo. Mundet që të nisë të konsiderojë uljen e taksës për lëndën e parë konkretisht grurin. Shtetet e rajonit e kanë me 4-6%, ka shtete edhe më pak. Ne e kemi 20% që është një taksë relativisht e lartë për një produkt të tillë.

**Disa furra rriten çmimin me 10 lekë; Paralajmërohet rritje në të gjithë tregun, nëse shtrenjtimi i miellit nuk ndalet**

Anëtarë të Shoqatës të Prodhuësve të Bukës, Pastiçerisë dhe

Brumërave, thanë për “Monitor” më herët se rritja e çmimit me 10 lekë prej dy javësh ka qenë individuale. Nëse rritja e çmimit të miellit do të vazhdojë, shtrenjtimi i bukës në të gjithë tregun është i pashmangshëm. “Nga disa operatorë në treg ka pasur rritje të çmimit të bukës me 10 lekë, për shkak të shtrenjtimit të çmimit të miellit me 5 lekë/kg, rritjes së çmimit të vajit, margarinës. Rritja ka qenë individuale, për shkak edhe të qirasë apo kreditë që mund të kenë prodhuësit e bukës.

Vështirësi janë krijuar edhe nga mungesa e punonjësve, që shumë prej tyre po emigrojnë, pasi kërkojnë paga të larta. Ende nuk ka rritje të çmimit të bukës nga të gjithë operatorët. Të tjerë janë përpjekur që të amortizojnë koston e lartë, por gradualisht rritja për 10 lekë për bukë pritet të nisë në të gjithë tregun, nëse do të vijohet me rritje të çmimit

të grurit”, pohuan anëtarë të Shoqatës të Prodhuësve të Bukës.

**Makaronat këtë vit do të kenë shtrenjtimin më të lartë**

Çmimi më i lartë te produktet e brumërave këtë vit pritet të jetë te makaronat. Arsyeja është dyfishimi i çmimit të grurit të fortë për prodhimin e makaronave. Vjet në vend, pas hapjes së ekonomisë, konsumi më i lartë ndër produktet e shportës ishte për makaronat. Në muajt e verës të vitit të kaluar, konsumi i makaronave u rrit 79% më shumë se në 2019-n, sipas drejtoreshës së financës, në kompaninë e tregimit të produkteve ushqimore, “Teuta”, znj. Junis Uruçi. Përfaqësuesja e kompanisë “Teuta” pohoi më herët për “Monitor” se rritje të lartë të konsumit në verën e 2020 pati edhe për drithërat e shëndetshme, me 74% më shumë se në 2019.





# TASE GROUP

Adresa: Rruga e Kavajës, Qendra Kondor (ish parku i autobuzave, poshtë "21 Dhjetorit"), Tiranë  
Tel: 0035542239968; Fax/Tel: 0035542220027; e-mail: [info@tasegroup.al](mailto:info@tasegroup.al);  
Website: [www.tasegroup.al](http://www.tasegroup.al); Celular: 0684855580 (Kushineta, Premistopa dhe rripa)  
Celular: 0672035581 (Pjesë këmbimi për traktorë)



## Ofrojmë:

- PJESE MOTORIKE
- FREKSIONE
- PERMISTOPA
- KUSHINETA
- RRIPIA
- AKSE
- PJESE ELEKTRIKE
- PJESE HIDRAULIKE
- VAJRA DHE FILTRA



# KASH

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

[www.kashalbania.org](http://www.kashalbania.org)

## Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar







Deri në **4 500 000 LEKË**

## KREDI PËR SERA PA KOLATERAL



## GJITHMONË FINANCË SOCIALE

Rr. Qemal Stafa, Pall. 9 katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i Ri, Tiranë.  
+355 4 2251910/1 | [info@fedinvest.al](mailto:info@fedinvest.al) | [www.fedinvest.al](http://www.fedinvest.al)



FAO në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nisën konsultimet për përgatitjen e planit kombëtar të veprimit për fermat familjare, në kuadër të Dekadës së Kombeve të Bashkuara për Bujqësinë Familjare 2019 – 2028.

Fokus i takimit që u zhvillua me këtë rast, ishin fermat familjare dhe ndërhyrjet për të kontribuar në një botë pa uri dhe varfëri, ku burimet natyrore menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme, dhe ku askush nuk mbetet pas.

Në fjalën e saj, ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, u ndal në rëndësinë e fermave familjare, jo vetëm si pjesë e rëndësishme në aspektin bujqësor, por edhe atë socio-ekonomik të vendit. Duke folur për strukturën e fermave shqiptare, për pronësinë e fermave të vogla familjare, madhësinë mesatare të tyre prej 1.2 ha, me dallime në rajone të ndryshme, dhe ku aktualisht 60 mijë ferma operojnë në treg, ministrja theksoi rëndësinë dhe peshën që zënë fermat familjare në prodhimin total bujqësor dhe blegtoral në Shqipëri. “Disa prej tyre kanë potencial për të rritur më tej produktivitetin, në këtë mënyrë edhe të ardhurat e tyre ekonomike. Përveç dimensionit ekonomik, ato përfaqësojnë një burim të rëndësishëm për zhvillimin social dhe mjedisor”,

## Ministria e Bujqësisë dhe FAO, plan kombëtar për fermat familjare

u shpreh ministrja Krifca, duke shtuar se përmes politikave të zhvillimit, programeve dhe instrumenteve për zbatim ministria ka në fokus mbështetjen e

për zhvillimin e agroturizmit, që kanë një kërkesë të lartë për këto produkte”, u shpreh Kipi.

Konsultimet me aktorët kryesorë nga institucionet shtetërore

tjerë, në mënyrë që programi për fermat familjare të jetë sa më gjithëpërfshirës”, përfundoi Kipi, përfaqësuesi i FAO-s në Shqipëri. Në vijim, Ministria e

si pjesë e aktivitetit bujqësor, por edhe të aktiviteteve të tjera si diversifikimi i aktivitetit ekonomik në fshat.

Më tej, ekspertët ndërkombehtarë nga Zyra Rajonale e FAO-s për Evropën dhe Azinë Qendrore prezantuan modele dhe rekomandime për Dekadën e Kombeve të Bashkuara lidhur me fermat familjare dhe ftuan

pjesëmarrësit në diskutime dhe konsultime paraprake për të koordinuar punën për planin kombëtar të veprimit.

Për sa i përket Planit Kombëtar të Veprimit, aktorët synojnë përshtetimin e veprimeve që do të ndërmerren në mënyrë kolektive, koherente dhe gjithëpërfshirëse për të mbështetur fermerët familjarë si aktorë kryesorë për zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor dhe rural.



fermave familjare, për qasje të orientuara drejt tregjeve potenciale me kërkesë të shtuar ndaj produkteve organike dhe të certifikuara.

Përfaqësuesi i FAO-s në Shqipëri Arben Kipi, falënderoi Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për bashkëpunimin në organizimin e aktivitetit, në kuadër të programit të OKB-së, shpallur dy vjet më parë për fermat familjare.

“Fermat familjare janë profili dominues i bujqësisë shqiptare, duke qenë bazë për zhvillimin e një bujqësie të gjelbër, zhvillimin e produkteve tradicionale, organike shqiptare, janë bazë

dhe fermerët janë në vijim të aktiviteteve që FAO ka organizuar këto muaj në mbështetje të fermave familjare.

“Ne synojmë të përfshijmë përfundimet e këtij takimi në lidhje me planin e veprimit në strategjinë e re sektoriale për zhvillimin bujqësor dhe rural, dhe për t’i hapur rrugën një programi të ri për katër vitet e ardhshme në mbështetje të fermave familjare. Përmes këtij programi ne do të bashkëpunojnë dhe koordinojnë nën drejtimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe me partnerë të tjerë, me GIZ, Agjencia italiane për Bashkëpunim në Zhvillim, Ambasadën holandeze, dhe të

Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca konfirmoi angazhimin e saj që konkluzionet nga ky takim do përfshihen në strategjinë kombëtare sektoriale.

Përfaqësuesja e GIZ, një partner i qëndrueshëm i Ministrisë në zhvillimin e agroturizmit dhe fermave familjare, Sofiola Kotelli, foli për intensifikimin e bashkëpunimit me Ministrinë në të gjithë komponentët e tjerë të projektit të zhvillimit të qëndrueshëm, duke u fokusuar në bashkëpunimin me FAO në lidhje me veprimet në drejtim të mbështetjes për fermat e familjare, si komponentë kryesorë të ekonomisë bujqësore, jo vetëm

### FAO aktivitet me fëmijët për ushqimin

Nxënësit e shkollës “Protagonist” dhe FAO Shqipëri (Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë) përfshihen në eventin e Junior World Food Day (Dita Botërore e Ushqimit për të Rinjtë) për përhapjen e mesazhit se si të rinjtë mund të ndërmarrin veprime për t’i bërë sistemet agro-ushqimore më të qëndrueshme.

Ne të gjithë mund të jemi Heronj të ushqimit, për një botë më të mirë dhe më të qëndrueshme!

Veprimet tona janë e ardhmja jonë!



(Vijon nga faqja 6)

Mendoj është si në rastin e vaksinimit kundra COVID 19, i cili nuk mund të jetë fare vullnetar, sipas dëshirës qytetarëve, sepse pasojat e mosvaksinimit i vuan gjithë komuniteti.

### 8. Kooperimi bujqësor, një rrugë që rrit forcën e bujqësisë sonë

Tashmë dihet nga të gjithë se kur bujqësia shqiptare futet në katër kanatat e analozës SWOT, në pikat e dobëta përmendet gjithmonë madhësia e fermës nën një madhësi normale të pranueshme. Ferma jonë është 3-5 herë më e vogël se mesatarja e fermave greke dhe italiane. Mesatarja e fermës tonë është vetëm rreth 1.3 ha.

Lind nevoja të diskutohet seriozisht se si mund të nxitet kooperimi në bujqësi. Pa organizimin e prodhimit të madh, do kemi vështirësi. Bujqësia jonë me fermat e vogla ngjason si kioskat, ndërsa supermarkatat janë me madhësinë e pallateve. Kioska nuk mund dot me pallatet.

### Cilat janë mekanizmat që mund t’i bëjë bashkë fermerët?

Janë disa lloje mekanizmesh, por standardet e larta, janë mekanizma që i detyron fermerët të bashkohen e të prodhojnë produkte me standardin e kërkuar.

Kur fermat janë në bashkësi kooperativiste, certifikimi, magazinimi, paketimi, transporti, kushtojnë me lirë. Edhe politika e çmimeve imponohet nga prodhimi i madh dhe jo nga prodhimi i vogël. Ngritja e kooperativave të produkteve për eksport, i detyron fermerët

që të unifikojnë kultivarët, përdorimin e inpueteve, tërheqjen e shërbimit këshillimor, ofrimin e importuesëve të mëdhenj etj.

### 9. Politika e skemave të mbështetjes financiare nga shteti ose projektet (subvencionet) duhet riparë.

Mendoj se duhet diskutuar më gjerë mbi politikën e mbështetjes financiare.

Duhet një barazpeshë mes investimeve për mbështetjen e fermave të vogla dhe investimeve për njësitë e mëdha prodhuese dhe përpunuese.

Sa shumë është investuar për fabrikat e vajit, por sa pak për prodhuesit e ullirit. Është investuar shumë për baxhot dhe thertoret, por sa pak për të mbështetur rritësit e kafshëve bujqësore si për gjedhin dhe të imtat.

Lista e objekteve që subvencionohen duhet të diversifikuar si më poshtë.

- Të mbështet metodat miqësore në mbrojtjen e bimëve, siç janë përdorimi i feromoneve çorientuese kundra insekteve, të cilët kufizojnë përdorimin e insekticideve konvencionalë deri në 50 % dhe në disa dëmtues deri 90 %.

- Përfshirja në subvencione e farërave dhe fidanave resistente ndaj sëmundjeve,

- Subvencionimi për nxitjen e plehërimin të gjelbër (farë bathe e bimë të tjera bishtajore plehëruese)

- Subvencione për përpunimin e plehut organik.

- Duhet të nxiten privatët të ngrenë fabrika të përpunimit të lëndëve organike e cila mund të mblidhet kudo dhe të prodhon plehra të ambalazuara dhe të standardizuara siç është torfa.

- Të subvencionohen aparatat elektronike për prognozësinjalizimin e sëmundjeve dhe dëmtuesëve (stacione moti dhe programe kompjuterike prognozimi)

- Të subvencionohet përdorimi në bujqësi i energjisë së rinovueshme si ajo diellore, e erës dhe biogazet nga përdorimi i biomasës së ricikluar etj.

- Të subvencionohen pjesërisht stafet e shërbimit këshillimor privat ose stafe private për fusha të ndryshme ekspertize. Partneriteti PPP, nuk duhet të zbatohet vetëm me investimet e mëdhej, por edhe me njësi private shumë më të vogla, por që janë shumëfrutdhënëse.

- Subvencionimi i pemës së fikut dhe e ndonjë bimë tjetër,

- Subvencionimi më thelbësor i bletarisë, e cila nuk prodhon vetëm mjaltë, por më shumë jep prodhim bujqësor.

- Subvencionimi i prodhimit të farërave të vendit dhe dyqanet që shesin produkte nga kultivarët dhe racat vendase.

### 10. Të mos harrojmë mekanizmin e vogël

Ndonëse bujqësia jonë është bujqësi me ferma të vogla, mekanizmi me mekanizma të vogla është i varfër.

Mekanizma të tilla ka në treg

për punimin e tokës, për kultivimet, për krasitjet, për vjeljet, trajtimet kimike, plehërimin kimik. Ky mekanizmi i vogël, të paktën rrit volumin e punës dhjetë herë, krahasuar me punimet bujqësore që kryhen me krahë.

### 11. Media e shkruar dhe ajo elektronike bujqësore

Media elektronike, private dhe publike, vërtetë e ka zgjeruar mbështetjen e bujqësisë dhe zonave fshatare, por ende nuk ka programe të integruara në funksion të politikave kombëtare shqiptare.

Media elektronike mund të shtojë programet, mund të zbatojë teknikat e reja siç janë DVD-të e CD-të profesionale, filmat bujqësorë etj. Këto teknika janë mjete shumë efektive për shpërndarjen e metodave inovative dhe përvojën pozitive.

Është e pakonceptueshme se si një vend bujqësor nuk ka një revistë kombëtare për bujqësinë. Kjo revistë ka filluar botimin nga viti 1924 deri në vitin 2006. Që nga ai vit, revista Bujqësia Shqiptare nuk bohohet më.

Mjetet elektronike, rrjetet sociale, nuk mund ta zëvendësojnë kurrë shtypin e shkruar bujqësor. Ndoshta ka ardhë koha që të ringrihet Qendra e Informacionit Bujqësor, me sektorët e revistës, librave, fletëpalosjeve, filmave dhe DVD-ve profesionale etj. Të gjitha institucionet furnizojnë këtë qendër me materiale profesionale. Edhe vendet më të zhvilluara, jo bujqësore kështu e

kanë të organizuar informacionin bujqësor. Një model i mirë për këtë është Gjermania.

### 12. Organizimi i kuvendeve bujqësore (konferenca, simpoziume, analiza vjetore e deri kongrese)

Dy veprimatit të mëdha kombëtare mbahen mend nga koha e moshës sime:

Në vitin 1972, u organizua Kongresi për Drejtshkrimin e Gjuhës Shqipe dhe në vitin 1975, u organizua Konferenca Kombëtare e Shkencave Bujqësore. Punimet e kësaj konference u botuan në një libër prej 808 faqesh.

Sot kushtet për organizime të tilla janë shumë më mirë se më parë.

P.sh. mund të fillohet me konferencat shkencore “ULLIRI, 2021” ose “MOLLA, 2021” ose “EKSPORTI I PERIMEVE 2021”

Në veprimtari të tilla përfshihen të gjitha institucionet, që nga ato shkencore e deri te prodhuesit private. Në këto veprimtari një bimë e veçantë trajtohet në thellësi që nga prodhimi e deri tek përpunimi e marketingu. Duke u zhvilluar me një kalendar të shpallur, këto veprimtari krijojnë traditë, krijojnë memorie, krijojnë përvojë e cila përmirësohet vazhdimisht.

### 13. Çdo familje, çdo shkollë, çdo institucion, duhet të jetë pjesë e gjelbërimit të Shqipërisë

Ka ardhur koha që edhe

qytetarët të zhvillojnë mikrobujqësinë urbane, ose bujqësinë e baçeve, shkollat të mbjellin, perime, lule, bimë dekorative, natyrisht në sipërfaqe të vogla. Shumë familje në fshat e lënë tokën pa punuar.

Në këto kushte shteti duhet të jetë i shqetësuar, pse mbetën kaq shumë njerëz jashtë gjelbërimit të Shqipërisë. Ka mekanizma ekonomike për nxjerrjen e mijëra njerëzve nga kafet te fushat dhe baçet e prodhimit bujqësor.

Puna me tokën dhe bimët, ka edhe rolin e vet edukativ, largon njerëzit nga punët e dobta, i harxhon energjitë në punë efektive dhe jo në repartet me veglat e dobësimit. Sot në Europë është një lëvizje e madhe në zgjerim për afrimin e njerëzve sa më pranë tokës. Ju lutem futuni në internet me këtë adresë të thjeshtë (www.urban agriculture) dhe do të gjeni punë të mrekullueshme që bëhet në bujqësinë e dobët. Rekomandoni edhe të tjerëve këtë adresë, sidomos fëmijëve, nipërve dhe mbesave tona.

Unë mendoj se këto argumenta dhe shumë të tjera që nuk arrita dot t’i përshkruaj, kontribuojnë në forcimin e bujqësisë sonë, në vendosjen e saj mbi shinat e ekonomisë dhe ekologjisë, por nga anat tjetër e bëjnë bujqësinë tonë gjithnjë e më të papavarur.

Unë desha të trajtoj këtë temë me këndvështrimin që të shtojmë prodhimin e vendit për të rritur njëkohësisht edhe pavarësinë më të gjerë të Shqipërisë.

Fundi pjesës se dytë.



MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

(Vijon nga gazeta paraardhëse)

TË USHQYERIT E KAFSHËVE TË FERMËS

Tabela 6. Hartimi i racioneve ushqimore komplet

|                   | Prodhimi i qumështit në ditë |       |       |        | Début lact. | Tharje |
|-------------------|------------------------------|-------|-------|--------|-------------|--------|
|                   |                              |       |       |        | 0-3 sem     |        |
|                   | <20 kg                       | 30 kg | 40 kg | 50 kg  |             |        |
|                   | <45 lb                       | 65 lb | 90 lb | 110 lb |             |        |
| Proteinë bruto %  | 12 - 15                      | 16    | 17    | 18     | 19          | 12     |
| PDR/%/PB          | 63                           | 61    | 60    | 55     | 55          | X      |
| PAI/%/PB          | 37                           | 39    | 40    | 45     | 45          | X      |
| Energjia          |                              |       |       |        |             |        |
| ENI/Mc/kg         | 1.42-1.52                    | 1.62  | 1.72  | 1.67   | 1.25        | X      |
| UNT/%/L.TH        | 63-67                        | 71    | 75    | 75     | 73          | 56     |
| Fibër             |                              |       |       |        |             |        |
| Fibër bruto/%     | 17                           | 17    | 15    | 15     | 17          | 22     |
| FDA /%            | 21                           | 21    | 19    | 19     | 21          | 27     |
| NDF/%             | 28                           | 28    | 25    | 25     | 28          | 35     |
| Minerale          |                              |       |       |        |             |        |
| Kalcium %         | 0.43-0.51                    | 0.58  | 0.64  | 0.66   | 0.77        | 0.39   |
| Potasium %        | 0.9                          | 0.9   | 1     | 1      | 1           | 0.65   |
| Fosfor %          | 0.28-0.51                    | 0.37  | 0.41  | 0.41   | 0.48        | 0.24   |
| Magnezi ppm       | 0.2                          | 0.2   | 0.25  | 0.25   | 0.25        | 0.2    |
| Squlur ppm        | 0.2                          | 2     | 2     | 2      | 2           | 0.16   |
| Sodë ppm          | 0.18                         | 18    | 0.18  | 0.18   | 0.18        | 0.1    |
| Klor pmm          | 0.25                         | 0.25  | 0.25  | 0.25   | 0.25        | 0.2    |
| Magnez ppm        | 40                           | 40    | 40    | 40     | 40          | 40     |
| Bakër ppm         | 10                           | 10    | 10    | 10     | 10          | 10     |
| Zing ppm          | 40                           | 40    | 40    | 40     | 40          | 40     |
| Hekur ppm         | 50                           | 50    | 50    | 50     | 50          | 50     |
| Kobalt ppm        | 50                           | 50    | 50    | 50     | 50          | 50     |
| Jodi ppm          | 6                            | 6     | 6     | 6      | 6           | 6      |
| Vitamina          |                              |       |       |        |             |        |
| Vitamine A, UI/kg | 3200                         | 3200  | 3200  | 3200   | 4000        | 4000   |
| Vitamine D, UI/kg | 1000                         | 1000  | 1000  | 1000   | 1000        | 1200   |
| Vitamine E, UI/kg | 15                           | 15    | 15    | 15     | 15          | 15     |

Të ushqyerit e gjedhit

Në të gjitha kohërat, pak a shumë në mënyrë empirike, njeriu është përpjekur të bëjë përmirësojë ushqimin e bagëtive të tij, veçanërisht nga momenti që ai ka të lashtat e kultivuara, produktet e të cilave ishin të destinuara për kafshët bujqësore. Kështu, me shekuj, janë bërë pak a shumë dallime të papërpunuar midis vlerave ushqyese të ushqimeve. Për shembull, afresket egjiptiane dhe mbetjet e silosave të gjetura rreth Mesdheut demonstrojnë qartë që teknika e silazhit ishte aplikuar që nga lashtësia. ose si justifikoni këtë praktikë përveç se duke kërkuar të ruani cilësinë e foragjereve për tu mbajtur? Hierarkitë e krijuara midis vlerave ushqimet ushqyese janë rafinuar ndër shekuj dhe kanë rezultuar në to krijimin e sistemeve të njësive të furnizimit, mjetet thelbësore për arsyetimin kafshët që ushqehen në mënyrë racionale. Për dijen tonë, ishte para fundit të shekullit të 17-të që krijuesit e “pointe “u përpoq të krijonte, duke praktikuar zëvendësime midis ushqimeve të ofruara për të njëjtin lloj kafshësh, një hierarki me vlerë ushqimore dhe për të shprehur kjo hierarki nga një unitet konkret. Pra, “ekuivalenti i sanëës” ishte një njësi e përdorur tashmë në Bohemia në shekullin e 18-të. Në këtë sistem, secili ushqim kishte një vlerë që ishte “treguese” e nivelit të performancës së lejuar nga krahasuar me sanë. Këto njësi sanë u përdorën dhe u mësuan në Francë deri në fundi i shekullit XIX. Kufijtë e një sistemi të tillë uniteti janë të dukshme sot, veçanërisht për shkak se vlera ushqyese e sanëve është shumë e ndryshueshme.

Tabela 1. Racione ushqimore për kadeqoritë e gjedhit

| Nr. | Ushqimet           | Lopë | Mëshqera | Vica     | Vica      | Vica     | Vica     |
|-----|--------------------|------|----------|----------|-----------|----------|----------|
|     |                    |      | 2-3 vjec | 1-2 vjec | 6-12 muaj | 4-6 muaj | 0-4 muaj |
|     | Jonxhë e njomë     | 30   | 15       | 10       | 5 - 8     | 2        | -----    |
|     | Silazh misri kalli | 12   | 10       | 8        | 3         | 2        | 1        |
|     | Silazh pranveror   | 5    | 5        | 3        | 2         | 1        | 0,5      |
|     | Jonxhë e thatë     | 3    | 2        | 1.5-2    | 1.5       | 1        | 1        |
|     | Loljum l thatë     | 2    | 1        | 1        | 1         | 0.5      | 0.2      |

Tabela 2. Nevojat ushqimore ditore (mirëmbajtje, prodhim dhe mbarsmëri) të lopëve të qumështit të racës

| Pesha e gjallë (kg)                                                                   | Proteine<br>(gr) | ENL<br>Mkal | Kalcium<br>(g) | Fosfor<br>(g) | Vit. A<br>1000 UI | Vit. D<br>1000 UI |
|---------------------------------------------------------------------------------------|------------------|-------------|----------------|---------------|-------------------|-------------------|
| Nevojat per mirembajtje per lopet adulte ne laktacion                                 |                  |             |                |               |                   |                   |
| 360                                                                                   | 350              | 6.65        | 14.5           | 10.4          | 28                | 11                |
| 410                                                                                   | 400              | 7.27        | 16.3           | 11.8          | 31                | 12                |
| 455                                                                                   | 418              | 7.86        | 18.6           | 13.1          | 34                | 14                |
| Mirembajtje + 2 muajt e fundit te mbarsmerise per lopet adulte ne tharje              |                  |             |                |               |                   |                   |
| 360                                                                                   | 663              | 8.65        | 24.1           | 14.5          | 28                | 11                |
| 410                                                                                   | 699              | 9.45        | 26.8           | 16.3          | 31                | 12                |
| 455                                                                                   | 731              | 10.22       | 30             | 18.1          | 34                | 14                |
| Nevojat per 1 kg qumesht me % te ndryshme yndyre                                      |                  |             |                |               |                   |                   |
| 5                                                                                     | 45               | 0.84        | 8.1            | 5             |                   |                   |
| 5.5                                                                                   | 48               | 0.88        | 8.6            | 5.3           |                   |                   |
| 6                                                                                     | 50               | 0.92        | 9              | 5.7           |                   |                   |
| Nevojat per shtese peshe, per te rivendosur p. gj. te humbur ne fillim te laktacionit |                  |             |                |               |                   |                   |
|                                                                                       | 145              | 2.32        |                |               |                   |                   |

Tabelë. Racion ushqimor orientues raca xhersi

| Racion ushqimor orientues |                    |                                |
|---------------------------|--------------------|--------------------------------|
|                           | Varianti me silazh | Variant pa silazh (me kullotë) |
| kg fizk/krerë/ditë        |                    |                                |
| Bari i thatë jonxhe       | 6 kg               | 7 kg                           |
| Kashtë (drith.+bisht)     | 1 kg               | 1 kg                           |
| Silazh misër kalli        | 15 kg              | -                              |
| Kullotë                   | -                  | 15 kg                          |



MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

TË USHQYERIT E KAFSHËVE TË FERMËS

(Vijon nga faqja 11)

Tabelë 3. Nevojat ushqimore ditore të lopëve barse të racës xhersi

| Lëndët ushqyese            | Njësia matëse | Sasia |
|----------------------------|---------------|-------|
| Lëndë e thatë              | Kg            | 10    |
| Njësi Ushqimore (NjU)      | „             | 7.8   |
| Energji neto për qumështin | MJ            | 460   |
| Energji Metabolike (EM)    | Mkal          | 21.5  |
| Proteinë Bruto             | G             | 1100  |
| Celulozë                   | „             | 1700  |
| Yndyrë                     | „             | 200   |
| Lëndë minerale             |               |       |
| Kalcium                    | G             | 37    |
| Fosfor                     | „             | 26    |
| Magnez                     | „             | 16    |
| Kalium                     | „             | 80    |
| Natrium                    | „             | 10    |
| Squfur                     | „             | 17    |
| Hekur                      | Ppm           | 500   |
| Kobalt                     | „             | 1     |
| Bakër                      | „             | 100   |
| Magnez                     | „             | 400   |
| Zink                       | „             | 400   |
| Jod                        | „             | 5     |
| Vit.A                      | UI            | 32000 |
| Vit.D                      | „             | 3000  |



(Vijon në numrin pasardhës)

Drejtoria e Teknologjive Blegtorale, QTTB-Fushë Krujë:  
E-mail: qttbfushekruje@yahoo.com

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE LUSHNJË

KËSHILLAT PËR FERMERËT QË DO TË MBJELLIN GRURË

Fermerët që mbjellin grurë gjatë kësaj periudhe, duhet të jenë të angazhuar në maksimum për të mbjellë me cilësi dhe në kohë këtë kulturë. Puna e tyre me grurin konsiston si më poshtë:

- në punimet e thella të tokës.
- në kujdesin për kullimin e sipërfaqeve që do mbillen me këtë kulturë.
- në sigurimin e plehërimit bazë (DAP, Superfosfat)
- përgatitjen e farës për mbjellje.
- sigurimin e farërave që vijnë nga hallka të larta (elite) për zonat përkatëse.

Në zonën e ulët bregdetare dhe në zona të tjera të kultivimit të grurit, fermeri të ketë në qendër të punës së tij disa kushte teknike për mbjelljen e grurit, të cilat po i japim më poshtë:

Së pari: Mbajtja në gatishmëri e rrjetit kullues është detyrë e ditës me qëllim që të krijohen kushte të përshtatshme për përgatitjen e tokës për mbjelljet.

Së dyti: Kujdesi për plugimin e sipërfaqes së tokës e cila do të mbillet me grurë.

Tokat më të përshtatshme për kultivimin e grurit janë tokat pjellore me taban të thellë të përshkueshme dhe të ajrosura mirë.

Parabima luan një rol të rëndësishëm në arritjen e rendimenteve të larta. Prandaj në këtë drejtim fermerët duhet të marrin shumë seriozisht paranimën, sepse gruri nuk jep rendimentin e kërkuar mbas vetes së tij.

Në bazë të mundësive fermerët do t'i këshillojmë që si paranimë të përdorin bimët bishtajore pasi ato janë paranimë më të mira të cilat përdoren edhe si pasurues të tokës. Për sa i përket punimit të tokës, këto punime do të jenë në varësi të paranimës.

Thellësia e punimit varet nga toka dhe kushtet klimatike, në rastet më të shpeshta ky punim kryhet në thellësi 26-35 cm.

Rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet jo vetëm përgatitjes së tokës por edhe plehërimit bazë, metodave, mënyrave dhe dozave të plehërimit (nuk rekomandohet plehërimi bazë me pleh organik para mbjelljes).

Përveç masave të përmendura më lart, vlen të theksohet fakti se nëse fermerët dëshirojnë të arrijnë rendimente sa më të larta atëherë, kujdes të veçantë do të duhet t'i kushtojnë përgatitjes së tokës me të mirë të shtratit të mbjelljes grurit. Në vendin tonë kryesisht dominojnë kultivarët dimërorë, prandaj në këtë drejtim rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet zgjedhjes së kultivarit të përshtatshëm për mbjellje në atë zonë.

Gjithashtu, kujdes të veçantë fermerët duhet t'i kushtojnë edhe evitimit të mbjelljes para afatit optimal. Në këto raste bima do të ketë rritje të bujshme dhe mundet të rrëzohet.

Në këtë shkrim të shkurtër më tepër do të tërheqim vëmendjen për kultivuesit e grurit të jenë angazhuar me kullimi e parcelave të caktuar me këtë kulturë.

- Ky muaj është kryesisht muaj i përgatitjes së tokës për mbjellje dhe kujdesit të veçantë

për grurin deri në mbjellje. Në zonat e larta malore nga fundi i muajit, duhet të fillojmë me mbjelljen e kësaj kulture. Duhet të kihet kujdes që rrjeti i brendshëm kullues i parcelave të jetë funksional dhe në gadishmëri. Marrje e rendimenteve të larta në grurë është e kushtëzuar me sigurimin e regjimit të përshtatshëm ujor në tokë nga mbirja deri në korje. Po qe se ky regjim do të priset nga teprica e ujit në tokë, pasojat do të jenë shumë të rënda: rrënjët mbesin në sipërfaqe e nuk zhvillohen në thellësi, priset aktiviteti mikrobiologjik, ulet koeficienti i shfrytëzimit të plehrave, toka ngjshet dhe priset struktura e saj

1. Kujdes në zonat malore ku mund të fillojë mbjellja duhet mbajtur parasyshtë respektimi i normës së farës, sepse kur përdor normë të lartë fare kemi bimë më shumë për m<sup>2</sup>, bimët duke qenë të dendura janë më të prekshme nga sëmundjet të ndryshme, kalliri nuk ka madhësinë e duhur dhe nuk ka numrin e duhur të kokrave dhe kallëzave si pasojë rendimenti ulet. Edhe kur norma e farës është më e ulët se normalja, përsëri nuk arrihet rendimenti i kërkuar si pasojë e rënies së numrit të bimëve për hektarë.

2. Përcaktimi i normës së farës për çdo kultivar.

3. Korigjimi i normës së farës sipas afatit të mbjelljes.

4. Thellësia e mbjelljes së farës, sipas afatëve kohore të mbjelljeve (në mbjelljet e hershme fara mbillet më thellë, e kundërta ndodh me mbjelljet e vona).

Për çdo kultivar ka normë të caktuar fare, (kjo përcaktohet nga pesha e 1000 kokrave). Thellësia e mbjelljes është 3-5 cm, varësisht nga përbërja e tokës dhe nga lagështia e tokës në momentin e mbjelljes. Gruri mbillet në bazë të objektivave që ka çdo fermer duke i vënë detyrë vetes që të ketë jo me pak se 500 bimë për metër katror.

Mesatarisht sasia e farës për hektar, është 220-250 kg/ha (22kg-25 kg /për dyn).

Për zonën, ulët bregdetare fermeri gjatë mbjelljes së grurit si rezultat i punimeve me mjetet mekanike të krijojë një shtresë sipërfaqësore të shkrifëruar (shtrati i farës), e cila do të jetë si bazë e mirë dhe do të ofrojë kushte të favorshme për mbirje të njëtrajtshme të farës. Mbajllja sipas tipeve të tokave (në tokat e rënda mbillet me herët, e kundërta ndodh në tokat e lehta dhe të mesme).

Duhen përdorur të gjitha mjetet mekanike që ka në dispozicion fermeri që të mbjellë dhe sigurojë numrin e bimëve për m<sup>2</sup>.

Në rast se përgatitja e tokës nuk do të jetë në nivelin e dëshirueshëm, si për shembull sipërfaqja tokësore nuk thërrmohet, nuk nivelohet dhe nuk krijohet masa e shkriftë, atëherë fara mund të mbetet e pambuluar, do të ketë mbirje jo të mirë, mund të dëmtohet nga zogjtë, për këtë arsye shtresa e sipërme e tokës në thellësi, duhet të përgatitet me kujdes të veçantë.

Drejtoria e Teknologjive Bujqesore, QTTB-Lushnjë;  
Sektori i Grurit; E-mail: qttblushnje@yahoo.com



FLORA SHQIPTARE

# 24 bimët magjike të tokës shqiptare - Zbuloni llojet mjekësore dhe aromatike

Në Shqipëri ka rreth 7233 lloje bimësh të cilat formojnë thuajse 32% të të gjithë florës së Evropës. Këtu futen edhe ato aroma-



tiket apo medicinalet që janë përdorur gjerësisht nga mjekësia popullore ndër shekuj.

Ndër to renditen dhe ato që në botë kërkohen vazhdimisht, e madje edhe eksportohen nga vendi ynë të cilat listohen më poshtë.

Ekspertja Florina Pazari në studimin mbi bimët mjekësore dhe aromatike në Shqipëri, rendit 24 prej tyre që janë më të përhapurat në vend.

Shumë prej jush mund t'i njohin e përdorin ato edhe nëpër shtëpitë e tyre.

Përgapja e shumicës së këtyre bimëve fillon nga Veriu në Jug, në lëndina, male e fusha.

## 1. Trumza

Trumza është një bimë tipike Mesdhetare që përdoret si për gatime ashtu edhe në spektrin mjekësor.

Përdorimet e saj në mjekësi

fillojnë që nga dhimbja e fytit ashtu dhe kundër kundër artritit.

## 2. Sherebela

Sherebela është një bimë shekullore që përdoret si në mjekësi si një kurë për lehtësimin e dhimbjeve po ashtu edhe në formën e çajit.

## 3. Zhumbrica

Kjo bimë me gjethe rozë është perfekte për tu rritur në zona të ngrohta dhe përdoret si për t'u ngrënë ashtu edhe në mjekësi.

## 4. Hithra

Hithrën e njohin të gjithë, pasi rritet në shumë zona të vendit.

Vetitë e saj kurative për organizmin po ashtu janë të njohura, siç është edhe byreku tradicional me hithra.

## 5. Boronica

Boronicën e maleve mund ta përdorni fare mirë si çaj ose si kurë kundër infeksioneve në organizëm.

## 6. Manushaqja

Mnushaqja është një lule ebukur që mund të rritet fare lehtë në kopshtet tuaja.

Kjo lule përmban acid salicilik dhe është një kurë e mrekullueshme për kujdesin e lëkurës.

## 7. Xhirokulli

Ka veti terapeutike dhe përdoret në shumë mediakamente e në mjekësinë popullore.

## 8. Murrizi

Kokrrat e kuqe të murrizit janë një mrekulli për shëndetin e zemrës.

Ato i gjeni të përhapura në pjesën më të madhe të vendit dhe çelin në periudhën Prill – Maj.

## 9. Finoku

Finoku përdoret gjerësisht në kuzhinë për shkak të aromës së mirë dhe vlerave që i dhuron organizmit.

## 10. Sanza/ Gentiana

Përdorimi më popullor i bimës është si përbërës aktiv i rakisë së sanzës, një pije tradicionale në malësi të vendit.

Gjithashtu ka edhe për-

dorime të tjera mjekësore.

## 11. Lulebasani

Lulebasani apo ndryshe lule maji është një barishte shumëvjeçare me lartësi deri në 1 m.

Ajo përdoret si nga mjekësia për kurimin e shumë sëmundjeve duke filluar që nga stomaku deri tek sistemi nervor.

Gjithashtu përdoret shumë edhe në produktet kozmetike dhe parfumeri për shkak të erës së mirë.

## 12. Dëllinja e zezë

Është një shkurre e lartë e cila përdoret kryesisht në mjekësi për kurimin e sëmundjeve ose në formën e çajit.

## 13. Dafina

Dafina hyn tek më të njohurat, atë mund ta përdorni në gatim për aromë të mirë, në mjekësi për kurimin e rrugëve të frymëmarrjes.

Në raste të veçanta mund ta gjeni të përdorur edhe si bimë aromatike për shkak të aromës së fortë freskuese.

## 14. Lavanda

Lavanda, livado apo lavandra është gjithashtu shumë e njohur.

Ajo përdoret masivisht si bimë aromatike, dekoruese, por jo vetëm.

Në shumë raste mund ta

gjeni përdorimin e saj edhe në mjekësi kundër diabetit, ulçerës apo reumatizmes.

## 15. Mëllaga

Në Shqipëri, mëllaga njihet si bimë medicinale e egër por kohët e fundit ka filluar të kultivohet.

Shtrihet nga zona bregdetare deri në ato të mesme malore.

## 16. Kamomili

Kamolili njihet për vetitë e tij kuruese dhe qetësuese në organizëm apo lëkurë në formën e çajit.

## 17. Bari i bletës

Bari i bletës është përdorur kundër inflamacionit bronkit, temperaturës, dhimbjeve të kokës, tensionit të gjakut, vrozës, çrregullimeve të humorit, dridhjeve, të vjellave dhe dhimbjeve të dhëmbëve.

## 18. Mendra e butë ose djegëse

Dhjozma ose nenexhiku janë shumë të përdorura në kuzhinë për shkak të aromës së mirë, në mjeksi për shkak të aftësive qetësuese dhe në kozmetikë.

## 19. Borziloku

Kjo bimë ka shumë fitonutrientë, minerale, vitamina që janë të rëndësishme për shën-

detin dhe mirëqenien e njeriut.

Shumë prej elementëve kimikë që gjenden tek borziloku kanë vlera të mëdha kundër inflamacionit dhe baktereve.

## 20. Rigoni i bardhë

Rigoni organik është efikas dhe i fuqishëm.

Ai është i pasur me karvakol, flavonoidë dhe substanca të tjera që luajnë rol zhblllokues dhe anti-alergjikë.

## 21. Lulëkuqja

Lulëkuqja ka aftësinë të fuqizojë sistemin imunitar, mbrojtë shëndetin e zemrës, përmirësojë shikimin, forcojë kockat, rrisë qarkullimin e gjakut, ndihmojë tretjen, rregullojë sistemin nervor, dhe parandalojë diabetin e tipit 2.

## 22. Xina

Kokrrat e kuqe të xinës janë të njohura për ndihmën që i japin sistemit të frymëmarrjes dhe mushkërive.

## 23. Agulicja

Gjethet e agulicës janë përdorur në përgatitjen e çajrave qetësues kundër pagjumësisë.

Breza të tërë e kanë përdorur atë kundër ankthit pikërisht për shkak të kësaj vetie.

## 24. Trëndafili i egër

Trëndafili i egër rritet në pyje e livadhe dhe ka një përdorim shumë të gjerë.

Shpesh mund ta gjeni si çaj të cilin mund ta përdorni edhe kundra gripit e të ftohurës.

# Këto janë produktet më toksike në frigoriferin tënd

Enët e paketimit të ushqimeve janë të rëndësishme për cilësinë dhe freskinë e tyre.

Megjithatë, materiali i përdorur në këto enë luan një rol thelbësor në aspektin shëndetësor të një ushqimi.

Në shumë shtëpi shqiptare,



ushqimet ruhen kryesisht në enë plastike që blihen lirë në treg.

Por këto produkte na kush-tojnë shtrenjtë për shëndetin

Materiali, veçanërisht plastika, arrin ta kthejë një ushqim të shëndetshëm në një ushqim toksik e kancerogjen

Plastika përmban një kimikat të njohur si bisphenol-A (BPA).

Ky kimikat është përdorur për krijimin e plastikës që në fillim të viteve 60' dhe vazhdon të përdoret edhe sot.

BPA-ja gjendet në shumë

prej paketimeve të ushqimeve dhe pijeve më të përdorura çdo ditë në botë siç është shishja e ujit, enët e kuzhinës, kanaçet, etj.

Kur ushqimi bie në kontakt me plastikën, metalin apo materiale të tjera, ka shumë gjasa

materialeve të tjera të dëmshme, ekspertët sugjerojnë përdorimin e qelqit, çelikut ose porcelanit për paketimin e ushqimeve.

## Disa mënyra për të "Mundur" plastikën

- Përdor trasta leckë dhe jo qese plastike për pazar.
- Përdor shishe uji shumë përdorimëshe.
- Mos përdor enë plastike për ruajtjen e ushqimeve.
- Mos përdor paketime një-përdorimshme, paketime të tepuara, pipëzat dhe plastika të tjera të disponueshme. Mbani me vete mjete të ripërdorshme.
- Kërko alternativa për të zëvendësuar plastikën në mjetet që përdorni.
- Riciklo. Nëse ju duhet të përdorni plastikën, përpiku të përdorësh numrin 1(PET) ose numrin 2(HDPE) të cilat janë plastikë e riciklueshme më të përdorshme. Evito qeset plastike apo ambalazhet e polisterolit (bukëpeshku) duke qenë se kanë koeficient riciklimi të ulët.
- Përhape fjalën. Flit me familjarët dhe miqtë për rëndësinë e reduktimit të përdorimit të lëndëve plastike në jetët tona dhe për ndikimin shkatërrimtar në shëndet dhe në mjedis.

AgroWeb.org

# Kujdesi që duhet të tregoni kur blini ushqime në konserva

Ritmi i shpejtë i jetës shpesh bëhet shkaktar edhe për mënyrat e gabuara që njerëzit bëjnë përsa i përket ushqimit.

Në shumë raste ushqimet e konservuara bëhen zgjidhja më

është e kundërta.

Në rastin e konservave situata është më kritike se zakonisht për disa arsye që i gjeni mëposhtë.

Para se ushqimet të futen



komode për shumë familje.

Gjithashtu shumë prej këtyre ushqimeve duke qenë se janë të pasura me kripëra mund të kthehen edhe në një shije të preferuar.

Në këtë artikull AgroWeb.org ju tregon disa arsye pse duhet të jeni shumë të kujdesshëm në zgjedhjen e tyre.

## Pse ushqimet e konservuara janë të rrezikshme

Mund të mendoni se dëmi që vjen nga ushqimi mund të mos jetë fatal, por në të vërtetë

në konserva ato ngrohen në mënyrë që të shkatërrohen bakteret e këqija që ndodhen në to.

Sipas një studimi të Universitetit të McGill të cilit i referohet AgroWeb.org, ushqimet e konservuara janë të dëmshme.

Kur ato ngrohen dhe qëndrojnë të konservuara për një kohë të gjatë humbasin çdo vlerë minerale.

## Kontrolloni gjendjen e konservës

Për të qenë gjithnjë të sig-

urtë në ushqimet që konsumoni gjithnjë kontrolloni kutinë.

Shikoni me kujdes në çfarë gjendje është metali i konservës para se t'a blini.

Sa më i hollë të jetë ky metal aq më shumë përkulen anët e tij duke krijuar kështu të çara mikroskopike që prekin ushqimin tuaj.

## Konservat e dëmtuara dhe helmimi nga ushqimi

Departamenti i Agrikulturës në SHBA, të cilit i referohet AgroWeb.org shpjegon se gjatë dëmtimit të kutive të konservave brenda tyre mund të zhvillohen forma bakteresh helmuese.

Këto baktere të rralla mund të prekin sistemin nervor dhe të shkaktojnë helmime të tmerrshme nga ushqimi.

Simptomat përfshijnë turbullim të shikimit, vështirësi në frymëmarrje apo përtypje.

Kjo njihet ndryshe si sëmundja e botulizmit, një gjendje ku trupit pushtohet nga toksinat nervore të shkaktuara nga bakteret.

Megjithëse është një sëmundje e rrallë evitoni sa më shumë kutitë e konservave të dëmtuara sadopak/AgroWeb.org



## BUJQËSIA NDRYSHE

## Bujqësia Biointensive

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

Në kohët e sotme kur popullsia e Botës po rritet me ritme të shpejta dhe ndër-kohë sipërfaqja e tokës së punueshme po pakësohet nga veprimi i faktorëve të ndryshëm, ka lindur nevoja e përpunimit të metodave të tjera të bujqësisë alternative. Një nga këto metoda është Bujqësia Biointensive.

Bujqësia biointensive është një sistem organik bujqësor që fokusohet në marrjen e rendimenteve maksimale nga një sipërfaqe minimale toke, duke rritur në të njëjtën kohë biodiversitetin dhe duke ruajtur pjellorinë e tokës. Qëllimi i metodës është qëndrueshmëria afatgjatë në një bazë të sistemit të mbyllur. Kjo është veçanërisht e efektshme për kopshtarët në oborrin e shtëpisë dhe fermerët e vegjël në vendet në zhvillim dhe gjithashtu është përdorur me sukses në fermat tregtare në shkallë të vogël.

Kjo metodë është e ngjashme me bujqësinë biodinamike dhe metodat e tjera bashkëkohore të bujqësisë alternative si bujqësia e karbonit, bujqësia e kalorive, bujqësia urbane etj.

Bujqësia biointensive ka rëndësi të madhe sepse globalisht, e ardhmja e bujqësisë po kërcënohet nga sfida të rënda si:

në shkallë globale mund të ketë edhe për 40 vjet tokë të mbarështueshme në botë; për çdo paund (425 gram) ushqim të ngrënë, humbasin 6 paund (2550 gram) deri 24 paund (10200 gram) tokë, për shkak të erozionit nga uji dhe era, si rezultat i praktikave bujqësore; rreth 95% e varieteteve të bimëve të kultivuara dikur në bujqësi tani janë praktikisht të zhdukur. Pjesa më e madhe e kësaj ka ardhur për shkak të pakësimit relativ të kultivimit të kulturave bujqësore dhe përdorimit të shpeshtë të farave hibride për kulturat bujqësore në qarkullim.

Ngrohja globale mund të pakësojë prodhimin bujqësor në gjysmën e tij brenda më pak se 20 vjetësh.


Nga derdhja e naftës dhe gazit natyror, bujqësia konvencionale - shumë e varur nga këto burime - do të bëhet më e shtrenjtë, duke rritur çmimet e ushqimit në përputhje me rrethanat.

Numri i fermerëve në nivel global vazhdon të ulet. Shumë njerëz dëshirojnë të merren me bujqësi, por nuk janë në gjendje të përballojnë tokën dhe pajisjet, që një fermë të jetë ekonomikisht e suksesshme.

Në sistemin e bujqësisë biointensive, pjelloria e tokës mbrohet dhe përmirësohet duke mbjellë rreth 60% të sipërfaqes me kultura që shërbejnë si kultura kompostimi. Njëpërmjet këtyre kulturave, mund të sigurohet që si kopshtari dhe toka do të ushqehen në mënyrë adekuate dhe se ferma do të jetë e qëndrueshme. Duke u nisur nga fakti se kjo metodë biologjikisht intensive kërkon shumë më pak tokë për të marrë të njëjtën prodhim të bimëve,

si nga bujqësia konvencionale, mund të themi se në rastin e bujqësisë biointensive mbetet një sipërfaqe e konsiderueshme toke. Kështu nëse kjo metodë përdoret globalisht, të paktën gjysma e sipërfaqes së tokës në botë mund të lihet në gjendje të egër (pa u shfrytëzuar) e cila mund të përdoret për ruajtjen e të gjithë diversitetit të bimëve dhe kafshëve të rëndësishme.

Shumë prej teknikave që kontribuojnë në metodën e bujqësisë biointensive kanë qenë të njohura dhe të pranishme në bujqësinë e kinezve të lashtë, grekëve, majave, dhe të periudhave të mëvonshme në Evropë, si dhe në Afrikën Perëndimore qysh nga fundi i shekullit të 18-të. Alan Chadwick, një mjeshtër anglez i kopshtarisë që në vitet 1940-1970, mbledhi së bashku metodat intensive të kopshtarisë biodinamike dhe franceze, si dhe qasjen e tij unike, për të formuar atë që ai e quajti Metoda Intensive Biodinamike-Franceze.



Alain Chadwick

Metoda e bujqësisë biointensive u zhvillua më tej nga John Jeavons (një bashkëthemelues i grupit "Ecology Action" (Veprimi Ekologjik) dhe babai i lëvizjes moderne të kopshtarisë biointensive). Ai së bashku me Ecology Action përpunuan një metodë të qëndrueshme 8 shkallëshe të rritjes së ushqimit, të njohur zyrtarisht si "Bujqësia e vogël e rritjes biointensive të qëndrueshme" dhe këtë program e përhapën në të gjithë Botën. Metoda tani gëzon praktikë të përhapur dhe zhvillim të mëtejshëm, dhe sipas Ecology Action (Veprimi Ekologjik), zbatohet në mbi 140 vende të botës, pothuajse në çdo klimë dhe në tokë ku rriten kulturat bujqësore ushqimore.

Ekzistojnë 8 parime kryesore që e dallojnë rritjen intensive nga metodat e tjera të mbjelljes intensive.

### 1. Përgatitja (punimi) i thellë i tokës

Në Rritjen intensive toka përgatitet duke përgatitur shtrët të ngritur dhe duke i punuar ata në një thellësi prej 60 cm. Kjo është mjaft unike. Metodatat tradicionale të bu-

jqësisë zakonisht e punojnë tokën në një thellësi prej 15-20 cm mesatarisht. Plugimi apo punimi i tokës kryhet për ajrim. Një tokë me strukturë të mirë të tokës përbëhet nga 50% ajër. Për ta realizuar këtë, kryhet punimi i dyfishtë i shtratit të tokës.

Gërmimi i dyfishtë, (ashtu si në bujqësinë biodinamike), konsiston në hapjen e një hendeku i thellë prej 30 cm, i cili gërmohet në gjerësinë e shtratit me një lopatë të sheshtë dhe dheu nga ky hendek i parë vendoset mënjanë. Nën këtë thellësi, gërmohet me një sfurk gërmimi metalik në thellësinë 30 cm, po në të njëjtën gjerësi. Dheu i hendekut të dytë që fillon, hidhet në hapësirën e zbrazët të hendekut të parë dhe shtresa e poshtme punohet me sfurkun metalik për gërmim. Ky proces përsëritet përgjatë gjatësisë së plotë të shtratit të mbjelljes. Hendeku i fundit mbushet me dheun që u hoq nga hendeku i parë. Rezultati është



John Jeavons

një shtrat i cili është përpunuar në një thellësi prej 60 cm. Kur një shtrat i tillë gërmohet dy herë, toka do të ketë drenazhim dhe ajrim më të madh, i cili lejon rrënjët të rriten shumë më thellë dhe të arrijnë më shumë lëndë ushqyese. Vlen të përmendet se toka e rëndë, e papërpunuar duhet të gërmohet dy herë çdo sezon, derisa toka të ketë arritur një strukturë të mirë dhe një ajrosje afatgjatë. Gjatë sezoneve të mëvonshme, mund të kryhet vetëm kultivimi i sipërfaqes në thellësi prej 5 deri në 10 cm, me një pirun



Përgatitja e shtratit të ngritur me punim të dyfishtë të tokës

metalik me kunja të gjata deri, sa të bëhet përsëri shkërritimi i dukshëm. Pas gërmimit të dyfishtë të sezonit të parë, përpunimi i thellë gjatë sezoneve

të mëvonshme mund të realizohet me një pirun (sfurk i madh metalik me 6 kunja), veçanërisht në rastet e minifer-mave më të mëdha ose fermave komerciale.

Kjo mënyrë lejon që të ajroset toka deri në 4 herë më thellë se në rastin e bujqësisë konvencionale dhe do të thotë që rrënjët e bimëve mund të kenë më shumë lëndë ushqyese, të mbajnë më shumë ujë dhe në përgjithësi të kenë më shumë hapësirë për t'u rritur. Më shumë rrënjë = më shumë bimë. Kjo është një nga mënyrat në të cilat mund prodhohet rendimente jashtëzakonisht të larta në një hapësirë kaq të vogël, e cila është një karakteristikë e metodës së Rritjes Intensive.

### 2. Kompostimi

Përgatitja e kompostos mjaft të pastër të plehrave është zemra e kësaj metode. Kompostimi lejon që bimët të transformojnë dhe ta pasurojnë tokën me lëndë organike, si dhe të kthejnë lëndët ushqyese në tokë. Për këtë qëllim, çdo vit, planifikohet të përgatitet sasi të mjaft kompostosh në mënyrë që të plotësohen shtrëtërit e planifikuar për t'u mbjellë pa përdorur burime të jashtme. Kjo bëhet duke shpërndarë 60% të sipërfaqes



Kompostimi i bimeve dhe mbeturinave bimore

së kultivimit për bimët e kompostimit. Kjo është mënyra se si ne jemi në gjendje të rritim pjellorinë e bollshme, aktuale, vit pas viti dhe për shekujt që do të vijnë. Shtimi i kompos-



tove në shtrëtërit e mbjelljes ndihmon në shumë drejtime duke shtuar lëndët ushqyese dhe lëndën organike, e cila është thelbësore për të ushqyer

të mbjellat si dhe mikrobet në tokë. Kompostoja zbërthen lëndët ushqyese që më parë ishin të padisponueshme për bimët për shkak të acideve të tyre humike, kështu që mund të bëjë që toka të jetë edhe më pjellore. Kompostoja mban ujin (që do të thotë se humbet më pak nga avullimi), mban lëndët ushqyese, përmirëson strukturën e tokës dhe mbron pH e tokës.

Qëllimi i kompostimit është që të futen në tokë organizma



Mbjellja intensive e bimeve në shtreter

dhe lëndë ushqyese të dobishme si dhe të përmirësohet kapaciteti mbajtës i ujit, kullimit dhe ajrimit. Gjatë kom-

kulturave bujqësore, të cilat në sistemin biointensiv lihen të dekompozohen në tokë, ku ndihmojnë të plehrojnë dhe lidhen së bashku me tokën, duke krijuar një strukturë të qëndrueshme toke. Kështu, kultura të tilla si jonxha, e cila ka rrënjë jashtëzakonisht të thella dhe thekra e drithërave, e cila ka një vëllim veçanërisht të lartë të rrënjëve, duhet të vlerësohen në këtë drejtim.

### 3. Mbjellja intensive

Ajri i tokës nga zhvillimi i strukturës së thellë të tokës, i kombinuar me kompostën e pasur me lëndë ushqyese dhe mikrobike, lejon që kulturat të mbillen intensivisht. Për të



mbjellë në mënyrë intensive, përgatiten shtrëtërit të mgritur 1.2-1.8 m të gjërë, (zakonisht 1.5 m) dhe me gjatësi 6 m, duke duke formuar një shtrat prej 10 m<sup>2</sup>.

Kulturat nuk mbillen në rreshta tradicionale sipas një modeli katror, por mbillen në një model gjashtëkëndor ose në trekëndësh në shtrat, në mënyrë që të mos mbetet asnjë hapësirë e panevojshme. Këto shtrëtërit të gjerë dhe hapësira të ngushta jo vetëm që lejojnë më shumë bimë për sipërfaqe (deri në 4 herë më shumë), por gjithashtu mundësojnë që bimët të formojnë një mulçirim të gjallë mbi tokë, duke mbajtur lagështi dhe duke mbuluar barërat e këqija. Në këtë mënyrë maksimizohet sipërfaqja mbjellëse e shtrëtërve. Kështu bimët kanë hapësirën e saktë të rritjes dhe përdorin të gjithë hapësirën e tokës.

Kur bimët arrijnë pjekjen e tyre, gjethet e tyre do të prekin gjethet e bimëve pranë tyre, duke krijuar një ombrellë mbi tokën, diçka që quhet "mulçirim i gjallë". Hija e krijuar prej tyre mban ujë në shtrat dhe minimizon sasinë e ujit të kërkuar nga bimët, gjithashtu mbron tokën dhe pengon rritjen e barërave të këqinj.

Mbjellja intensive maksimizon sasinë e kalorive që prodhohen, kështu që mund të merret maksimumi i kalorive nga sipërfaqe më të vogla. Kjo është mënyrë shumë e mire për hapësirat urbane.



## BUJQËSIA NDRYSHE

(Vijon nga faqja 14)

#### 4. Mbjellja e bimëve shoqëruese

Mbjellja e bimëve shoqëruese bazohet në njohjen dhe shfrytëzimin e cilësive etributeve më të mira të bimëve dhe përdorimin e tyre në praktikën bujqësore. Mbjellja bashkëshoqëruese përshkruhet si zënie vendi në hapësirë, e cila tradicionalisht quhet mbjellje bashkëshoqëruese dhe në kohë, e cila tradicionalisht quhet qarkullim kulturash. Mbjellja e shoqëruesve mund të përdoret për të përmirësuar shëndetin dhe zhvillimin e të mbjellave dhe gjithashtu si një formë tjetër e mbjelljes intensive, e cila përdor hapësirën vertikale në mënyrë më efikase duke përzier bimë me rrënjë të cekta me bimë me rrënjë të thella ose bimë me rritje të ngadaltë me bimë me rritje të shpejtë.

Kjo mënyrë krijon një kopsht edhe më të lulëzuar, di-

trupat e tyre të bimëve. Një mrekulli kjo, që duke kultivuar bimët, ne marrim karbon nga ajri dhe e kthejmë atë në material fizik të bimëve. Kur vilet prodhimi, karboni në trupin e tyre, gjatë gjithë procesit të kompostimit, transformohet në një formë më të qëndrueshme të karbonit ose të lëndës organike dhe ky vendoset në tokë për ta pasuruar atë. Lënda organike është vendimtare për një sistem bujqësor të balancuar dhe ka përfitime të pabesueshme. Ajo ushqen mikrobet e tokës dhe marrëdhënia e tyre me sistemin e rrënjëve të bimëve është kritike për një sistem të balancuar dhe të lulëzuar të kopshtit.

Shumë kultura cerealesh cilësohen si bimë kompostimi, përveç që sigurojnë ushqim dhe bollëk kompostimi. Disa nga kulturat e kompostimit mund të rriten gjatë dimrit, kur toka do të ishte nga ana

#### 6. Bujqësia e Kalorive

Në bujqësinë e kalorive, kujdesi tregohet për të prodhuar mjaftueshëm energji ushqimore (dhe ushqyes të tjerë) në një sipërfaqe minimale.

Bimët rrënjore përdoren shpesh në bujqësinë e kalorive, sepse lejojnë fermerët dhe kopshtarët biointensivë të rritin më shumë lëndë ushqyese në sipërfaqe më të vogla, duke rezultuar në më pak punë për kalori dhe më shumë sipërfaqe toke për gjendje të egër (të papunuar) dhe njerëz të tjerë. Këto kultura, të cilat kanë përmbajtje të lartë në kalori për njësi peshe dhe një rendiment të lartë për sipërfaqe, përfshijnë patate, patate të ëmbla, hudhër, presh, rodhe, topinamburi dhe majdanos. Këto kultura mund të prodhojnë 5 deri në 20 herë më shumë kalori për njësi të sipërfaqes për njësi të kohës. Në bujqësinë biointensive, 30 % e tokës së kultivuar për ushqim përdoret për kulturat rrënjore.

Bimët që përdorim për të rritur karbonin gjithashtu kanë ngarkesa të kalorive në to si: misri, nenza, thekra, elbi, gruri, që kanë veprimin e dyfishtë të sigurimit të pjellorisë afatgjatë të tokës dhe të ushqyerit e saj. Kjo është arsyeja pse metoda e Rritjes Biointensive është projektuar për fermerët

të ndryshme (secila me karakteristika që ata dëshirojnë të “kalojnë” në brezin e ardhshëm) dhe ky kryqëzim bëhet me dorë nga njerëzit. Por farat hibride, megjithë avantazhin e tyre për prodhim më të lartë, nuk mund të ruhen dhe të kultivohen çdo vit dhe në se kjo ndodh teknikisht, nuk do të ketë një kulturë të besueshme vitin e ardhshëm. Pasardhësit do të jenë një përzierje e të dy tipareve të prindërve, kështu që do të përfundojnë me një shumëllojshmëri të gjerë të karakteristikave të bimëve. Farat nga kulturat me polenizim të hapur ndërkaq kanë tipare fikse dhe do të jenë të ngjashme me prindërit e tyre, duke lejuar kështu që të zgjidhen farat nga bimët më të mira dhe më të fuqishme. Në këtë mënyrë me kalimin e kohës, do të përfundohet në prodhime të përshtatura për mjedisin lokal.

Përdorimi i farërave me polenizim të hapur siguron diversitetin gjenetik dhe i lejon fermerit të jetë i pavarur, duke kultivuar farat nga bimët e tij dhe duke kultivuar varietetet më të përshtatshme për atë rajon të veçantë.

#### 8. Metoda si një sistem i tërë

Për të patur rezultate pozitive në zbatimin e metodës së Bujqësisë Intensive, në

rohet seriozisht toka. Ashtu siç ndodh që nga zbatimi i drejtë i Rritjes Biointensive mund të prodhohen sasi të konsiderueshme të ushqimit dhe të sigurohet rritje e pjellorisë së tokës, ashtu mund të ndodhë që mund të shkatërrohet pjelloria e tokës, bile në një shkallë alarmante, kur kjo metodë nuk zbatohet drejt.

Qëllimi i metodës biointensive është qëndrueshmëria, por nëse teknikat në lidhje me produktivitetin praktikohen pa integruar teknikat që kanë të bëjnë me pjellorinë e qëndrueshme të tokës, toka mund të varfërohet edhe më shpejt se sa me metodat tradicionale bujqësore. Elementi më i rëndësishëm për ndërtimin dhe mbajtjen e pjellorisë së qëndrueshme të tokës është kultivimi i 60 % e bimëve për kompostim, teknikat e duhura të kompostimit që përfshijnë balancën e duhur të materialeve të pjekura të karbonit të zi dhe të materialeve të gjelbër azotikë kompostimi dhe kur është e mundur edhe riciklimi i mbeturinave njerëzore të sigurta dhe ligjore.

Ndonse Bujqësia biointensive është e përqendruar në prodhimin e ushqimeve vegane, kjo nuk do të thotë se ajo duhet të përjashtojë rritjen e kafshëve. Kafshët, ndonëse nuk konsiderohen nga praktikuesit e kësaj metode, si biointensive të qëndrueshme, mund të inkorporohen në sisteme biointensive, megjithëse kërkojnë rritjen në mënyrë të konsiderueshme të sipërfaqes së tokës dhe të punës që kërkojnë për rritjen e tyre.

Kështu, normalisht nevojitet rreth 4000 m2 tokë kullotë për 1 lopë qumështi ose 2 dhi apo 2 dele, ndërkohë që dieta e balancuar vegane e një personi mund të prodhohet në rreth 400 m2, një sipërfaqe toke shumë më e vogël.

Por duke patur parasysh se në vitin 2014, rreth 90 % e popullsisë së botës ka patur qasje deri në rreth 418 metra katrorë të tokës bujqësore për person, duke llogaritur këtu që të lihet një sipërfaqe e barabartë në gjendje të egër (të pashfrytëzuar), për të mbrojtur diversitetin gjenetik të bimëve dhe kafshëve dhe ekosistemet botërore, kjo përbën një sfidë të madhe për njerëzimin.

Sistemi i qëndrueshëm biointensiv, i cili thekson ruajtjen e biodiversitetit; riciklimin e lëndëve ushqyese; sinergjinë midis kulturave, kafshëve, tokës dhe përbërësve të tjerë biologjikë; dhe rigjenerimin dhe ruajtjen e burimeve, është një lloj qasjeje agroekologjike. Kjo është një qasje alternative që mund të adresojë në mënyrë të përshtatshme çështjen qendrore të urisë, varfërisë, pasigurisë ushqimore dhe të

jetesës. Ajo ka shërbyer si një model për promovimin e fermave ekologjike dhe eko-turizmit për prodhime më të larta dhe gjenerim të të ardhurave në shkallë të vogël.

Metoda biointensive siguron shumë përfitime krahasuar me metodat konvencionale të bujqësisë dhe kopshtarisë dhe është një metodë e prodhimit të qëndrueshëm dhe të lirë që mund të përdoret nga njerëzit që nuk kanë burime për të zbatuar bujqësinë komerciale të bazuar në forma kimike dhe lëndën djegëse fosile.

Sipas të dhënave të Ecology Action (Veprimi Ekologjik) del se metodat biointensive mund të mundësojnë fermat e vogla dhe fermerët të rrisin ndjeshëm prodhimin e ushqimit dhe të ardhurat, të shfrytëzojnë kryesisht burimet lokale, burimet e rinovueshme dhe të ulin shpenzimet dhe inputet e energjisë, ndërkohë që krijojnë një shtresë të lartë pjellorë të tokës në një normë 60 herë më shpejt se në natyrë.

Po sipas këtyre të dhënave fermerët që përdorin teknikat biointensive kanë mundësi për të përdorur 67% deri në 88% më pak ujë sesa metodat tradicionale bujqësore, të përdorin 50% deri në 100% më pak plehra komerciale të blera (organike, rrethanore vendore), të prodhojnë 2 deri 6 herë më shumë ushqime në rendimentet e ndërmjetme dhe të sigurojnë një rritje 100% të pjellorisë së tokës.

Në këtë mënyrë, vogëlohet me 50% ose më shumë sasia e tokës që kërkohet për të prodhuar të njëjtën sasi të krahasueshme të ushqimit. Kjo lejon që të mbetet më shumë sipërfaqe toke për të ruajtur shërbimet e ekosistemit dhe promovimin e diversitetit gjenetik.

Metoda e Bujqësisë Biointensive jo vetëm që ka gjetur zbatim në praktikën bujqësore por ajo ka marrë dhe miratimin e shumë autoriteteve shkencore në Botë.

Dr. Ed Glenn në Laboratorin për Hulumtime Mjedisore, Universiteti i Arizonës, në SHBA, ka kryer studime për këtë metodë dhe ka botuar disa artikuj shkencorë mbi përparësitë e kësaj metode.

Një studim i vitit 2010, i kryer nga S. R. Moore dhe i botuar në revistën “Renewable Agriculture and Food Systems” tregoi se metodat biointensive rezultuan në një rritje të konsiderueshme të prodhimit dhe në një reduktim të përdorimit të energjisë në krahasim me bujqësinë konvencionale.

Në vitin 2010, UNCCD (Konventa e Kombeve të Bashkuara për Luftimin e Desertifikimit) publikoi një material që detajonte përfitimet e bujqësisë biointensive, (Grow Biointensive System), si një mjet për të luftuar shkretëtirëzimin.



Mbjellja e bimeve bashkeshoqëruese

namik dhe të balancuar. Në këtë praktikë ndërthuren dhe lulet për të tërhequr insekte të dobishme. Kështu mund të mbjellim fasule me misër për të rregulluar gjendjen e azotit (duke rimbushur azotin që tërhiqet nga misri), duke mbrojtur tokën dhe misri vepron si mbështetës për fasulet që të rriten. Po kështu dihet mirë që domatja dhe borziloku rriten mjaft mirë së bashku, kështu që ato mund të ndërthuren së bashku. Kas-travecat kërkojnë hije, kështu që ata mund të shoqërohen me disa prej kulturave më të larta. Në këtë drejtim ka shembuj të pafund. Qëllimi këtu është krijimi një biodiversiteti sa më të madh të jetë e mundur dhe shfrytëzimi i karakteristikave të veçanta të çdo kulture në avantazhin e fermerit.

#### 5. Bujqësia e karbonit

Bujqësia e karbonit është më shumë një vazhdim i ndërtimit të komposteve të plehrave. Gjatë rritjes dhe zhvillimit të tyre bimët fiksojnë karbonin nga atmosfera (më saktë CO<sub>2</sub>, gaz karbonik) dhe përmes procesit të fotosintezës, ato e konvertojnë atë në lidhje të karbonit dhe krijojnë

tjetër e papërdorur. Kulturat që rriten për karbon përfshijnë drithrat si misri, quinoa, gruri, thekra, melakuqi, nenëza, lulëdielli etj. Ata kanë një sasi të mirë të materialeve “kafe” ose “materiale të pjekur” ose karbon strukturor, i cili në fund kthehet në më shumë humus, që është qëllimi përfundimtar i metodës biointensive, pasi humusi është material me qëndrueshmëri të lartë, të pabesueshme dhe që mund të zgjasë deri në 5.000 vjet.

Disa nga kulturat e kompostimit kanë përmbajtje më të larta në karbon, ndërsa të tjerët kanë përmbajtje më të lartë në azot ose fiksojnë azotin në tokë. Për këtë qëllim është e nevojshme që për kompostim duhet të krijohet proporcioni i dëshiruar i secilës lloj kulture për të arritur efektivitetin maksimal. Gjithashtu, disa kultura kompostimi marrin lëndë ushqyese të veçanta të dëshiruara nga nëntoka dhe i përqendrojnë ato në kompostim, duke lejuar kështu një rishpërndarje të atyre ushqyesve në prodhimet ushqimore. Ky proporcioni i kulturave të kompostimit prej 60 % është vendimtar për qëndrueshmërinë që është qëllimi i metodës biointensive dhe pjellorisë së kopshtit.



Patatja, bime karboni dhe kalorie

e ekzistencës. Për ata që duan të kenë një ngastër toke, rruga më e mirë është zbatimi i bujqësisë biointensive. Në këtë mënyrë mund të sigurohen të gjitha kaloritë e nevojshme, të gjitha plehrat e nevojshme, në sasi më të vogël të tokës, për një kohë të pacaktuar shumë të gjatë. Kjo siguron dhe pavarësinë e ushqimit.

#### 7. Përdorimi i farave të bimëve me polenizim të hapur

Këto janë fara që rrjedhin nga polenizimi natyral i bimëve të ndryshme, nga insektet ose era dhe kanë origjinën nga prindër të ngjashëm të një varieteti. Ato ndryshojnë nga farat hibride, të cilat janë rezultat i kryqëzimit me dashje të 2 llojeve të bimëve

mënyrë që ajo të rezultojë me produktivitet intensiv dhe rendiment të lartë, është e domosdoshme që sistemi të praktikohet si një i tërë në mënyrë që të parandalojë rraskapitjen e shpejtë të tokës.

Kjo do të thotë që parimet përbërëse të saj duhet të zbatohen të gjitha së bashku, pa neglizhuar ose mënjanuar ndonjërin prej tyre. Është e njohur tashmë se çfarë ndodh kur manipulohet një sistem apo entitet i tërë funksional (shembull është industria ushqimore e produkteve të përpunuara dhe paketuara dhe impakti që ka pasur në shëndetin e njerzve). Ky parim i fundit do të thotë se duhet të përdoren të gjitha pjesët përbërëse të Rritjes Biointensive së bashku si një e vetme. Nëse nuk bëhet kjo, atëhere rrezikohet të shkatër-



# KREDI PËR ÇDO SIPERMARRËS

KREDI E SHPEJTË ME NORMA KONKURRUESE

deri në  
**7 MILIONË**  
Lekë

